




ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

RAPORTI VJETOR 2009



FJALA HYRËSE

Të dashur lexues,

Para jush e keni Raportin e pestë vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Raporti paraqet një pasqyrë të aktiviteteve dhe të arritjeve kryesore të ZRRE-së, të zhvilluara gjatë vitit kalendarik 2009. Raporti është hartuar për të siguruar informacione mbi progresin e punëve të ZRRE-së në arritjen e qëllimeve strategjike e saj, disa prej të cilave do të vazhdojnë përtej vitit 2009. Raporti përmban një pasqyrë të ngjarjeve më të rëndësishme në tregun e energjisë, si dhe të dhëna thelbësore teknike e komerciale për aktivitetet e rregulluara në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës.

Raporti është strukturuar në pajtim me dispozitat e nenit 10 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe bashkë me llogaritë financiare i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim, shqyrtim e miratim.

Sektori i energjisë në Republikën e Kosovës është në një proces të ristrukturimit dhe të liberalizimit. Me qëllim të lehtësimit të këtij procesi, qeveria ka rishikuar strategjinë e energjisë dhe ka hartuar Projektligjet kryesore të sektorit të energjisë, përfshirë edhe Projektligjin për Rregullatorin. Këto projektligje janë harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe pritet të shqyrtohen e të miratohen nga Kuvendi i Kosovës. Në anën tjetër, ZRRE ka vazhduar ta kompletojë legjislacionin dytësor, me hartimin e miratimin e rregullave të reja, si dhe me plotësimin e harmonizimin e atyre ekzistuese.

Në pajtim me planet zhvillimore janë kryer investime të rëndësishme në sistemin e transmisionit që kanë rezultuar me zvogëlimin e fyteve të ngushta, me përmirësimin e profilit të tensionin dhe me ulje të humbjeve teknike të energjisë. Forcimi i linjave ndërlidhëse me vendet do të krijojë kushtet bazë për zhvillimin e një tregu konkurrues të energjisë dhe për rritjen e besueshmërisë së furnizimit me energji.

Në rrjetin e shpërndarjes nuk janë bërë investime të mjaftueshme. Gjendja e rrjetit mbetet e dobët, që ka për pasojë humbje të mëdha teknike të energjisë dhe cilësi e siguri të dobët të shërbimit të konsumatorëve. Edhe më tutje, problemi më i madh mbetet kontrollimi i shpenzimit të energjisë dhe niveli i lartë i humbjeve joteknike (komerciale) nga abuzimet në matje të energjisë dhe nga niveli i ulët i arkëtimit të energjisë së faturuar.

Gjeneratorët vendorë nuk kanë prodhuar energji të mjaftueshme për t'i plotësuar kërkesat e konsumit gjithnjë në rritje. Një pjesë e energjisë së munguar është importuar nga tregu rajonal me çmime relativisht të larta. Në periudha të ndryshme, sidomos në orët e pikut, ka pasur shkurtime të furnizimit të konsumatorëve me energji.

Hapja e minierës së re të Sibovcit jugperëndimor ka vazhduar me ritme të përshpejtuara për të siguruar linjit të mjaftueshëm për të dy centralet elektrike.

Procesi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese ka vazhduar përmes realizimit të projektit të TC Kosova e Re. Ndërkohë, pakoja e projektit është rikonfiguruar dhe në fund të vitit Qeveria ka vendosur që të rishpallet thirrja për shprehjen e interesit të investitorëve potencialë për ndërtimin e këtij TC. Gjatë këtij viti po ashtu është përfunduar projekti i fizibilitetit për Hidrocentralin e Zhurit, si mundësi potenciale e ndërtimit të tij me angazhimin e kapitalit privat .

Në lëmin e shfrytëzimit të energjive të ripërtërishme janë bërë hapa të rëndësishëm në kompletimin e kornizës rregullative. Për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese me erë kanë aplikuar katër investitorë. ZRRE ka lëshuar një autorizim përfundimtar dhe një fillestar, ndërkaq dy të tjera janë në procedurë të shqyrtimit.

Me qëllim të bashkërenditjes së aktiviteteve që kanë të bëjnë me zbatimin e strategjisë dhe të politikave në sektorin e energjisë, ZRRE ka bashkëpunuar me komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës, me ministritë relevante të qeverisë, me përfaqësuesit e industrisë dhe të konsumatorëve, si dhe me të gjitha palët e interesit.

Zyra ka vazhduar ta bëjë monitorimin e të licencuarve për të konstatuar nëse aktivitetet e tyre kryhen në pajtim me kushtet e licencave të lëshuara, me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimit e të furnizimit të sigurt të konsumatorëve.

ZRRE ka marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet dhe proceset lidhur me Traktatin e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore (KEJL), në Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB) dhe në të grupet punuese në kuadër të tij. Po ashtu, ZRRE ka vazhduar bashkëpunimin me institucione e organizata ndërkombëtare në lëmin e rregullimit, siç është edhe Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (ERRE).

Edhe në këtë vit ZRRE ka vazhduar me aftësimin e kuadrove në aspektin, profesional, menaxherial e administrativ, për t'i përmbushur detyrat e saj në mënyrë sa më të efektshme, profesionale e transparente. Për këtë qëllim kemi pasur ndihmesë të vlefshme teknike nga donatorët si UE, USAID-i dhe Banka Botërore.

Në fund, jam i lumtur të theksoj se edhe gjatë këtij viti bordi dhe i gjithë stafi i ZRRE-së ka kryer me sukses të gjitha punët dhe përgjegjësitë e caktuara me ligjet dhe aktet përkatëse që rregullojnë aktivitetet e veçanta në lëmin e energjisë. Andaj, për angazhimin dhe përkushtimin e tyre, dua t'i falënderoj të gjithë kolegët, bashkëpunëtorët dhe stafin e ZRRE-së, si dhe të gjitha ato institucione e individë që, në çfarëdo mënyre, na kanë ndihmuar në kryerjen me sukses të punëve dhe të detyrave tona.

Me respekt,



Dr. Ali Hamiti

Kryesues i Bordit

PËRMBAJTJA

1. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ZYRËN E RREGULLATORIT PËR ENERGJI.....	7
1.1 MANDATI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI.....	7
1.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRE-SË	7
1.2.1 Bordi udhëheqës	7
1.2.2 Departamenti Ligjor dhe i Licencimit.....	8
1.2.3 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve	8
1.2.4 Departamenti për Furnizim me Energji dhe Strukturë të Tregut	8
1.2.5 Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave	8
1.2.6 Grupi Teknik Këshillëdhënës dhe Zyra Administrative	8
1.3 NGRITJA E KAPACITETEVE TË ZRRE-SË – PROJEKTET E ASISTENCËS TEKNIKE, KURSET DHE TRAJNIMET.....	9
1.3.1 Projektet e asistencës teknike.....	9
1.3.2 Kurset dhe trajnimet.....	10
1.4 MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE TRANSPARENCA	10
2. RAPORTI FINANCIAR	11
2.1 TË HYRAT	11
2.2 BUXHETI	11
2.3 SHPENZIMET BUXHETORE.....	12
3. KOMPLETIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE RREGULLATIVE.....	15
3.1 LEGJISLACIONI SEKONDAR	15
3.1.1 Rregullat e ndryshuara (amendamentuara).....	15
3.1.2 Rregullat e hartuara	15
3.1.3 Dokumentet e përgatitura nga ndërmarrjet e licencuara	15
3.2 ANGAZHIMI NË HARTIMIN E LEGJISLACIONIT PRIMAR	16
3.3 BURIMET E RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË	16
3.4 LICENCIMI I NDËRMARRJEVE TË ENERGJISË	17
3.4.1 Lëshimi i licencave	18
3.4.2 Vazhdimi i licencave	18
3.4.3 Transferi i licencës	18
3.5 MONITORIMI I NDËRMARRJEVE TË ENERGJISË	18
4. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË	20
4.1 RRJETI I TRANSMISIONIT	20
4.2 RRJETI I SHPËRNDARJES	23
4.2.1 Struktura e stabilimenteve të rrjetit të shpërndarjes.....	23
4.3 STANDARDET E CILËSISË SË FURNIZIMIT DHE SHËRBIMIT	24
4.3.1 Kontinuiteti i furnizimit.....	24
4.3.2 Cilësia e tensionit.....	25
4.3.3 Cilësia komerciale	25
4.4 PRODHIMI I LINJITIT DHE I ENERGJISË ELEKTRIKE	25
4.4.1 Prodhimi i linjitit	25
4.4.2 Prodhimi i energjisë elektrike	26
4.5 KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE	28
4.5.1 Konsumi në shpërndarje	29
4.6 FURNIZIMI I KONSUMATORËVE ME ENERGJI ELEKTRIKE SIPAS SKEMËS ABC	31
4.7 HUMBJET E ENERGJISË ELEKTRIKE.....	31
4.7.1 Humbjet e energjisë elektrike në transmision	31

4.7.2 Humbjet në shpërndarje	32
4.8 FATURIMI DHE ARKËTIMI	33
4.9 TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE	34
4.9.1 Rrjedhat e energjisë elektrike 2009	34
4.9.2 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike	35
4.9.3 Krahësimi i çmimeve të importit me vendet e rajonit	38
4.10 SHQYRTIMI I TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE	39
4.10.1 Shqyrtimi i tretë i tarifave të energjisë elektrike	39
4.10.2 Përcaktimi i tarifave të energjisë elektrike	39
4.10.3 Tarifa me Blloqe	41
4.10.4 Parimi i shpërndarjes së kostos	41
4.10.5 Krahësimi i tarifave të energjisë elektrike në rajonin e EJT	42
4.11 AKTIVITETET E ZRRE-SË RRETH NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA GJENERUESE	44
4.12 HIDROCENTRALI I ZHURIT DHE PERSPEKTIVAT E MUNDSHME TË NDËRTIMIT	46
5 SEKTORI I NGROHJES QENDRORE.....	47
5.1 KORNIZA LIGJORE PËR SEKTORIN E NGROHJES QENDRORE	47
5.2 PASQYRË E PËRGJITHSHME E SEKTORIT TË NGROHJES QENDRORE.....	47
5.3 TË DHËNAT TEKNIKE PËR SISTEMET E NGROHJES QENDRORE NË KOSOVË	47
5.3.1 Gjenerimi dhe shpërndarja e ngrohjes.....	47
5.3.2 Konsumi i lëndëve djegëse dhe çmimi	48
5.4 FURNIZIMI, FATURIMI DHE ARKËTIMI	49
5.4.1 Shërbimi i furnizimit.....	49
5.4.2 Faturnimi dhe arkëtimi	50
5.5 TARIFAT E NGROHJES QENDRORE	50
5.5.1 Metodologjia tarifore	50
6 MBROJTJA E KONSUMATORËVE.....	53
6.1 ANKESAT DHE AKTIVITETET NË ZGJIDHJEN E KONTESTEVE	53
7 PERSPEKTIVA E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË KOSOVË.....	55
8 AKTIVITETETI NDËRKOMBËTAR I ZRRE-SË.....	58
8.1 ZRRE-JA DHE TRAKTATI I KOMUNITETIT TË ENERGJISË SË EVROPËS JUGLINDORE	58
8.1.1 Aktivitetet e BRRKE gjatë vitit 2009.....	59
8.2 ASOCIACIONI I RREGULLATORËVE RAJONALË PËR ENERGJI.....	61
8.3 PARTNERITETI NDËRMJET ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË DHE KOMISIONIT KOMERCIAL TË SHTETIT ILLINOIS, SHBA.....	62

SHKURTESAT

AT	Autotransformator
BETSEE	Balance Energy Tool for South East Europe
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
BRR	Bordi Rregullator
DÇT	Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave
DLL	Departamenti Ligjor dhe i Licencimit
DMK	Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
ECLO	European Commission Liaison Office
EFT	Energy Financing Team
EJL	Evropa Juglindore
ENTSO-E	European Network of Transmission System Operators for Electricity
ERRA	Energy Regulators Regional Association
FEST	Furnizimi me Energji dhe Strukturë Tregu
FLSA	Financial Law Smart Agency
FP	Furnizuesi Publik
GPG	Grupi Punues për Gaz
GTE	Gas Transmission Europe
GWh	Gigavatorë
HC	Hidrocentral
ICC	Illinois Commerce Commission
ICO	International Civilian Office
ITC	Inter TSO Compensation
KE	Komuniteti i Energjisë
KEEJL	Komuniteti i Energjisë në Evropën Juglindore
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESH	Korporata Energjetike e Shqipërisë
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KK	Kuvendi Komunal
km	Kilometër
KNQ	Kompani për Ngrohje Qendrore
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut në Kosovë
KPD	Komiteti Drejtues i Projektit
kV	Kilovolt
kVA	Kilovoltamper
kW	Kilovat
kWh	Kilovatorë
LNG	Liquid Natural Gas
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MJ	Megaxhul
MVA	Megavoltamper
MW	Megavat
MWh	Megavatorë
NARUC	National Association of Regulatory Utility Commissioners
NQ	Ngrohje Qendrore
NS	Nënstacioni
NjPNQ	Njësia Punuese e Ngrohjes Qendrore
OS	Operator Sistemi
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operator i Sistemit të Transmisionit

OT	Operator Tregu
PATEL	Projekti Asistenca Teknike Energjia nga Linjiti
PURK	Public Utility Research Center
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition
Sh.a	Shoqëri aksionare
Sh.p.k	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
TAP	Transmission Adriatic Pipelines
TC	Termocentral
TCKR	Termocentrali Kosova e Re
TF	Task Force
TGI	Turkish Greece Interconnection (Interkonekcioni Turqi-Greqi)
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
TKEEJL	Traktati i Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore
TL	Tensioni i lartë
TR	Transformator
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

1. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ZYRËN E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

1.1 Mandati i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), sipas nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është institucion i pavarur, që ushtron rregullimin ekonomik në sektor të energjisë elektrike, të ngrohjes qendrore dhe të gazit natyror, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë 2004/9 dhe Ligjin e ndryshuar Nr.03/L-080 të datës 13 qershor 2008.

Detyra kryesore e ZRRE-së është që të krijojë kushte për furnizimin të sigurt të konsumatorëve me energji, duke ruajtur mjedisin e pastër, të ndërtojë një treg konkurrues të energjisë në Kosovë, që do të bazohet mbi parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

Përgjegjësitë e Zyrës së Rregullatorit për Energji janë të përcaktuara në Nenin 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe ushtrohen përmes: lëshimit, modifikimit, tërheqjes, monitorimit të licencave për aktivitetet e energjisë, dhënies së autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë, aprovimit të metodologjive të çmimeve dhe tarifave për aktivitetet që nuk i nënshtrohen tregut të lirë, nxjerrjes së legjislacionit dytësor, monitorimit të ndarjes efektive të aktiviteteve në sektorin e energjisë, zhvillimit të konkurrencës, si dhe zgjidhjes së kontesteve në mes të licencuarve e konsumatorëve.

1.2 Struktura organizative e ZRRE-së

ZRRE në strukturën e saj ka Bordin udhëheqës, të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, katër departamente kryesore, grupin teknik këshillëdhënës dhe administratën.

1.2.1 Bordi udhëheqës

Bordi udhëheqës përbëhet nga pesë anëtarë, përfshirë edhe kryesuesin e Bordit, i cili njëkohësisht është edhe udhëheqës i ZRRE-së. Kuvendi i Kosovës, në dhjetor 2008, ka bërë emërimin e dy anëtarëve të rinj të bordit, kështu që në fillim të vitit 2009 Bordi ka qenë i kompletuar dhe plotësisht funksional.

Anëtarët e Bordit propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi dhe janë anëtar të rregullt të stafit të ZRRE-së.

Kryesuesi i Bordit, për aktivitetet e ZRRE-së dhe për zhvillimet në sektorin e energjisë, i raporton Kuvendit të Kosovës dhe komisioneve funksionale të tij, sipas kërkesës së tyre, me kontakte e njoftime të kohëpaskohshme dhe me Raportin vjetor.

Bordi i përmbush detyrat e tij në përputhje me detyrat e përgjegjësitë që i janë dhënë me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë.

Gjatë viti 2009 Bordi ka mbajtur 13 takime, në të cilat ka shqyrtuar çështje të ndryshme në rregullimin e sektorit të energjisë dhe ka marrë 68 vendime, të gjitha të bëra publike në faqen elektronike të ZRRE-së. Vendimet më të rëndësishme të Bordit janë specifikuar te raportimi sipas departamenteve përkatëse.

Po ashtu, Bordi ka organizuar dhe ka mbikëqyrur aktivitetet e ZRRE-së, duke përfshirë emërimin e menaxherëve dhe personelit të ZRRE-së, aprovimin e afateve dhe kushteve të punësimit për anëtarët e stafit, përgatitjen e buxhetit dhe menaxhimin financiar të ZRRE-së.

Anëtarët e Bordit kanë bashkëpunuar dhe kanë marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e rëndësishme që janë zhvilluar në sektorin e energjisë në Kosovë dhe në rajon. Takimet e Bordit janë të hapura për publikun dhe paralajmërohen pesë ditë para mbajtjes së tyre, me publikimin e rendit të ditës në faqen elektronike.

1.2.2 Departamenti Ligjor dhe i Licencimit

Departamenti Ligjor dhe i Licencimit (DLL) i siguron ZRRE-së mbështetje ligjore sipas ligjeve në fuqi në Kosovë, për të gjitha çështjet në sektorin e energjisë, përgatit legjislacionin dytësor dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe është përgjegjës për përgatitjen e të gjitha llojeve të licencave, aplikacioneve, procedurave dhe autorizimeve në sektorin e energjisë. DLL bën mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të licencuara.

1.2.3 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) është përgjegjës për sigurimin e aplikimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë dhe merret me ankesat e konsumatorëve dhe me zgjidhjen e kontesteve ndërmjet të licencuarve. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi, ky departament bashkëpunon me të gjitha organizatat të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

1.2.4 Departamenti për Furnizim me Energji dhe Strukturë të Tregut

Departamenti për Furnizim me Energji dhe Strukturë të Tregut (FEST) merret me vlerësimin dhe analizën e të dhënave në sektorin e energjisë elektrike. Analizon ndikimin e faktorëve të ndryshëm si: çmimet e formuara në tregun e lirë dhe çmimet e rregulluara për konsumatorit fundor, zhvlerësimet, inflacionin, çmimin e lëndës djegëse, etj. FEST gjithashtu bën edhe monitorimin e tregut të energjisë elektrike.

1.2.5 Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave

Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave (DÇT) analizon aplikacionet e sistemeve tarifore të propozuara nga subjektet e licencuara. Krijon sistemin e monitorimit të kostos. Përpilon studime mbi kostot dhe çmimet që janë të krahasueshme në mes kompanive nacionale dhe atyre ndërkombëtare. Gjithashtu, ky departament është përgjegjës për modelimin dhe analizimin e çmimeve në tregun e energjisë.

1.2.6 Grupi Teknik Këshillëdhënës dhe Zyra Administrative

Grupi Teknik Këshillëdhënës përbëhet nga ekspertë të sektorit të energjisë që kanë për detyrë ofrimin e këshillave teknike Bordit dhe Departamenteve të ZRRE-së në përmbushjen e funksioneve të tyre.

Zyra Administrative është përgjegjëse për ofrimin e përkrahjes administrative Bordit dhe Departamenteve të ZRRE-së, për përmbushjen sa më efektive të detyrave të tyre.




Fig.1.1. Skema organizative e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

1.3 Ngritja e kapaciteteve të ZRRE-së – projektet e asistencës teknike, kurset dhe trajnimet

ZRRE i kushton vëmendje të veçantë ngritjes së vazhdueshme profesionale të personelit të saj, me qëllim të përmbushjes efikase të detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore. Për këtë qëllim ZRRE ka hartuar projekt-propozime dhe për disa nga to ka siguruar financim nga donatorë të ndryshëm.

1.3.1 Projektet e asistencës teknike

Projekti “Asistencë Zyrës së Rregullatorit për Energji” në vlerë kontraktuese prej 985,600 €, financuar dhe administruar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO – European Commission Liaison Office). Projekti me kohëzgjatje 22 muaj ka filluar në nëntor të vitit 2008 dhe akoma është duke u zhvilluar dhe zbatuar nga konsorciumi i kompanive konsulente ndërkombëtare LDK Consultants-ECA-Planet.

Qëllimi themelor i këtij projekti është përkrahja e ZRR-së në zhvillimin dhe kompletimin e mëtejme të legjislacionit dytësor, në zbatimin efikas të procedurave rregullatore dhe në përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga ligjet e energjisë të Kosovës dhe nga obligimet e TKE të EJT.

Projekti “Krijimi i kornizës rregullatore për burimet e ripërtërishme të energjisë”, i financuar nga Banka Botërore dhe i zbatuar nga kompania konsulente ndërkombëtare “Mercados”. Ky projekt në vlerë kontraktuale prej rreth 176,000 € është zhvilluar gjatë periudhës janar – tetor 2009.

Qëllimi kryesor i këtij projekti ka qenë përkrahja e ZRRE-së për të zhvilluar komponentët kryesorë të kornizës rregullative për energjinë e përfutur nga burimet e ripërtërishme dhe të ngritë kapacitetet profesionale për të përmbushur detyrat e saj rregullative, bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar kurse trajnimi dhe punëtori me tema nga detyrat përkatëse të projektit, si dhe vizita studimore në Spanjë dhe Itali, me qëllim të njoftimit me praktikën më të mirë rregullative në fushën e burimeve të ripërtërishme të energjisë.

Projekti “Konsulencë për të asistuar në privatizimin e distribucionit dhe furnizimit të KEK-ut”, është financuar nga USAID-i dhe është duke u zbatuar nga kontraktori “Advanced Engineering Associates International Inc” (AEAI). Ky është një program dyvjeçar i asistencës, që ka filluar në shtator 2009, për të ndihmuar realizimin e suksesshëm të transaksioneve të ndërlidhura me privatizimin e shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut, përmes këshillëdhënies palëve të përfshira në sektorin e energjisë në Kosovë.

Njëra nga dy komponentët e projektit i dedikohet ZRRE-së, për ta asistuar në plotësimin, qartësimin ose dhe, sipas nevojës, zhvillimin e legjislacionin përkatës, në mënyrë që detyrat specifike të ZRRE-së të ndërlidhura me transaksionet përkatëse të mbështesin në mënyrë efikase procesin e privatizimit të shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut. Kjo komponentë do të përfshijë edhe ndihmesën në fazën e mëvonshme të post-privatizimit.

Projekti “Zhvillimi i sistemit të menaxhimit elektronik të dokumentacionit dhe informatave për ZRRE-në” është financuar nga buxheti i ZRRE-së, në vlerë prej 68,000 €. Zbatimi i projektit ka filluar në shtator të vitit 2009 dhe është në zhvillim e sipër, me synim kryesor rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në punë.

1.3.2 Kurset dhe trajnimet

Personeli i ZRRE-së gjatë vitit 2009 ka vijuar dhe përfunduar me sukses disa kurse dhe trajnime të cilat janë renditur në mënyrë kronologjike.

- Maj – qershor 2009 – Kursi “e-learning”: “Hyrje në rregullimin e tregjeve të gazit natyror dhe ngrohjes qendrore”, organizuar nga Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (“Energy Regulators Regional Association – ERRA”);
- Qershor 2009 – Trajnimi: “Rregullimi i ndërmarrjeve dhe strategjia e tyre”; mbajtur në Universitetin e Floridas dhe organizuar nga Qendra për Hulumtime dhe Shërbime Publike (“Public Utility Research Center – PURK”);
- Qershor 2009 – Trajnimi: “Rregullimi i çmimeve dhe tarifave”, organizuar nga Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (“Energy Regulators Regional Association – ERRA”);
- Tetor 2009 – Punëtorja: “Hartimi i Planit të veprimit për regjistrimin e të dhënave të sektorit të energjisë”, organizuar nga Sekretariati i TKE me seli në Vjenë;
- Tetor 2009 – Kursi: “Prokurimi elektronik dhe praktikat më të mira të Prokurimit Publik”, i cili është organizuar nga Kompania FLSA;
- Nëntor 2009 – Trajnimi: “Rregullimi i energjisë së ripërtërishme”, organizuar nga Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (“Energy Regulators Regional Association – ERRA”); dhe
- Nëntor 2009 - dhjetor 2010 – Kursi “e-learning”: “Aktivitetet monitoruese të autoriteteve rregullative”, organizuar nga Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (“Energy Regulators Regional Association – ERRA”).

1.4 Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca

Edhe gjatë vitit 2009 ZRRE për të gjitha aktivitetet e saj ka informuar në mënyrë të rregullt dhe transparente të gjitha palët e interesit dhe publikun e gjerë.

Në këtë vit është bërë ridizajnimi i faqes elektronike të ZRRE-së, me qëllim që të jetë edhe më funksionale dhe me e përdorshme për të gjithë të interesuarit, posaçërisht për konsumatorët e sektorit të energjisë.

Në faqen elektronike janë të publikuara, përveç të tjerave, njoftimet për takimet e Bordit, vendimet e marra nga Bordi, rregullat, udhëzimet dhe procedurat që rregullojnë sektorin e energjisë, tarifat e energjisë elektrike dhe të ngrohjes qendrore, licencat e lëshuara ndërmarrjeve të energjisë, raportet mujore dhe vjetore që paraqesin të gjitha aktivitetet e ZRRE-së etj.

ZRRE ka hartuar Strategjinë për Marrëdhënie me Publikun, me synim të një komunikimi sa më të mirë me palët e interesuara, për të siguruar transparencë për aktivitetet e ZRRE-së, duke vazhduar të publikojë të gjitha vendimet e marra nga Bordi, legjislacionin primar e sekondar, kodet e ndryshme, udhëzime dhe informata, që janë me interes për konsumatorët, institucionet, ndërmarrjet e energjisë dhe publikun e gjerë.

Kjo strategji ka paraparë edhe vazhdimin e komunikimit me të gjitha mediat në Kosovë, me qëllim të informimit të saktë të publikut me çështjet e ndryshme nga sektori i energjisë.

Si çdo vit, ZRRE ka përcjellë me kujdes të gjitha raportimet nga mediat për sektorin e energjisë, si dhe është përgjigjur me përpikëri në pyetjet dhe interesimet e mediave për çështje të ndryshme nga sektori i energjisë. Mediat në përgjithësi i kanë kushtuar hapësirë të konsiderueshme sektorit të energjisë, si dhe aktivitetëve të ZRRE-së. Raportimi i tyre ka qenë kryesisht korrekt dhe i paanshëm.

2. RAPORTI FINANCIAR

Zyra e Rregullatorit për Energji financohet nga të hyrat vetjake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, kreu 4, përkatësisht nga taksat që mblihen nga ndërmarrjet dhe operatorët e licencuar në sektorin e energjisë.

2.1 Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura të Zyrës së Rregullatorit për Energji janë depozituar në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe nenin 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në llogarinë zyrtare bankare të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Në vitin 2009, Zyra e Rregullatorit për Energji ka realizuar të hyra në shumë prej 467,223.42 €. Duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, ZRRE nga të hyrat e pashpenzuara të vitit 2008, ka bartur në vitin 2009 shumën prej 549,249.00 €. Shuma totale e të hyrave të realizuara dhe të bartura për vitin 2009 është 1,016,472.42 €, gjegjësisht 30,484.42 € më shumë sesa buxheti i ZRRE-së për vitin 2009. Me qëllim të harmonizimit të të Hyrave me Buxhetin, Bordi i ZRRE-së, në seancën e mbajtur më 15 prill 2009, ka marrë vendim që, për periudhën kohore shkurt- tetor 2009, të licencuarit të lirohen nga obligimi i pagesës së taksës fillestare dhe vjetore për shërbimet e ZRRE-së. Kështu të licencuarit janë liruar nga pagesa e taksave në një shumë të përgjithshme prej 819,909.54 €.

Kjo shumë e mjeteve do të kihet parasysh gjatë bashkërenditjes dhe përcaktimit të të Hyrave të Lejuara për ndërmarrjet e energjisë për vitin 2010 dhe do të reflektohet në tarifat e konsumatorëve të rregulluar.

Tab. 2.1. Të hyrat

Përshkrimi	Të hyrat
Të hyrat vetjake 2009	467,223.42
Të hyrat vetjake të bartura nga viti 2008	549,249.00
Gjithsej të hyrat	1,016,472.42

2.2 Buxheti

Kuvendi i Kosovës, me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr. 03/L-105 për vitin 2009, ka miratuar buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në shumë prej 985,988.00 €, i ndarë në kategoritë kryesore ekonomike si në vijim:

Tab.2.2. Buxheti në fillim të vitit

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	364,988.00
Mallra dhe shërbime	562,000.00
Shpenzime komunale	12,000.00
Shpenzime kapitale	47,000.00

Struktura buxhetit të Zyrës së Rregullatorit për Energji gjatë procesit të rishikimit është ndryshuar ashtu që shuma e mjeteve prej 112,000.00 € është transferuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategorinë e shpenzimeve kapitale, përderisa buxheti në total nuk ka ndryshuar.

Tab.2.3. Buxheti pas rishikimit

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	364,988.00
Mallra dhe shërbime	450,000.00
Shpenzime komunale	12,000.00
Shpenzime kapitale	159,000.00

2.3 Shpenzimet buxhetore

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2009, ZRRE ka shpenzuar 574,058.56 €, prej tyre 328,365.26 € nga të hyrat vetjake të vitit 2009, ndërsa 245,693.30 € nga të hyrat e bartura nga viti 2008.

Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet e ZRRE-së janë si vijon:

Tab. 2.4. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe mëditje	294,426.83
Mallra dhe shërbime	191,715.33
Shpenzime komunale	7,081.65
Shpenzime kapitale	80,834.75
Totali	574,058.56

Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e aprovuar për vitin fiskal 2009 është 58.22%.

Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është e paraqitur në tabelën 2.5.

Tab. 2.5. Realizimi i buxhetit i shprehur në përqindje

Përshkrimi	Të buxhetuara	Të realizuara	Ndryshimi	Realizimi në %
Paga dhe mëditje	364,988.00	294,426.83	70,561.17	80.67%
Mallra dhe shërbime	450,000.00	191,715.33	258,284.67	42.60%
Shpenzime komunale	12,000.00	7,081.65	4,918.35	59.01%
Shpenzime kapitale	159,000.00	80,834.75	78,165.25	50.84%
Totali	985,988.00	574,058.56	411,929.44	58.22%




Fig.2.1. Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Në grafikun e mësipërm është paraqitur pjesëmarrja e secilës kategori të shpenzimeve në shumën e gjithëmbarshme të shpenzimeve të realizuara në vitin fiskal 2009.

Në tabelat në vijim pasqyrohen shpenzimet sipas nënkategorive kryesore ekonomike.

Tab.2.6. Pagat dhe mëditjet

PAGAT DHE MËDITJET	SHUMA
Pagat neto	246,146.48
Tatimi i ndalur në të ardhura personale	20,239.69
Kontributet pensionale të punëdhënësit	14,020.33
Kontributet pensionale të të punësuarve	14,020.33
Gjithsej pagat dhe mëditjet	294,426.83

Tab.2.7. Mallrat dhe shërbimet

MALLRAT DHE SHËRBIMET	SHUMA
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	137.60
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	26,291.69
Internet	3,109.95
Shpenzimet e tjera telefonike (tel.roaming dhe kartela mbushëse)	9,713.34
Shpenzimet postare	274.00
Shërbimet arsimore dhe trajnuese	8,064.00
Shërbime teknike	78.00
Shërbime për printim	413.00
Shërbime të tjera kontraktuese	4,371.30
Shpenzimet për anëtarim	700.00
Mobile	1,740.00
Telefona	2,490.00
Pajisje të tjera	2,826.30
Kompjuter	7,344.00
Harduer për teknologji informative	1,694.00
Furnizim me ushqim dhe pije	2,692.30
Akomodimi	7,546.98
Naftë për ngrohje qendrore	5,597.52
Derivate për gjenerator	473.50
Karburant për vetura	1,470.96
Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	1,029.83
Sigurimi i ndërtesave	8,815.72
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	1,269.08
Mirëmbajtja e ndërtesave	8,640.00
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	2,808.50
Qiraja për ndërtesa	57,216.00
Reklamat dhe konkurset	13,743.08
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	316.00
Drekat zyrtare	2,468.27
Furnizime për zyrë	8,380.41
Gjithsej mallra dhe shërbime	191,715.33

Tab.2.8. Shpenzimet komunale

SHPENZIMET KOMUNALE	SHUMA
Rryma	5,257.60
Uji	347.38
Shpenzimet e telefonit fiks	1,476.67
Gjithsej shpenzime komunale	7,081.65

Tab.2.9. Shpenzimet kapitale

SHPENZIMET KAPITALE	SHUMA
Pajisje të teknologjisë informative	13,576.80
Softuer	20,412.60
Automjete	27,535.00
Pasuri e paprekshme	19,310.35
Gjithsej shpenzime kapitale	80,834.75

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2009 ZRRE ka arkëtuar të hyra në vlerë prej 1,016,472.42 €, që janë më të larta sesa shpenzimet buxhetore të realizuara në vlerë prej 574,058.56 €. Ndryshimi mes të hyrave dhe shpenzimeve në vlerë prej 442,413.86 €, paraqet fondet suficitare që ZRRE ka mbledhur gjatë këtij viti dhe të cilat, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe nenin 6 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, do të barten në vitin 2010.

Tab.2.10. Të hyrat vetjake të bartura

Të hyrat vetjake të bartura në vitin 2010	442,413.86
Të hyrat e bartura nga viti 2008	549,249.00
Të hyrat e pranuar gjatë vitit 2009	467,223.42
Gjithsej të hyrat 2009	1,016,472.42
Shpenzimet për paga dhe mëditje	294,426.83
Shpenzimet për mallra dhe shërbime	191,715.33
Shpenzimet komunale	7,081.65
Shpenzimet kapitale	80,834.75
Gjithsej shpenzimet 2009	574,058.56

3. KOMPLETIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE RREGULLATIVE

3.1 Legjislacioni sekondar

Bazuar në mandatin e saj të dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe me qëllim të kompletimit të kornizës rregullative për Sektorin e energjisë të Kosovës, ZRRE edhe gjatë vitit 2009 ka vazhduar me zhvillimin e legjislacionit sekondar (Rregullave dhe Procedurave).

Të gjitha rregullat dhe procedurat që janë nxjerrë ose ndryshuar nga ZRRE-ja, kanë kaluar nëpër fazën e konsultimit publik dhe janë miratuar në seancat publike të Bordit të ZRRE-së.

3.1.1 Rregullat e ndryshuara (amendamentuara)

Rrethanat e reja në tregun e energjisë në Kosovë kanë paraqitur nevojën e ndryshimit të disa rregullave. Pas një procesi të konsultimit publik dhe komenteve të marra nga palët e interesit, Bordi i ZRRE-së ka miratuar ndryshimet e këtyre rregullave:

- Rregulla mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, dhe
- Rregulla për Shkëqjen dhe Rikëqjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

3.1.2 Rregullat e hartuara

Gjatë këtij viti ZRRE ka hartuar projekt-rregullat që kanë të bëjnë me nxitjen dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe nga bashkëgjenerimi, si dhe Projekt-Procedurën për Konsumatorë të privilegjuar.

- Projekt-Rregulla për Krijimin e Sistemit të Certifikatës së Origjinës (për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme, nga mbeturinat, si dhe bashkëgjenerimi i energjisë elektrike dhe termike).

Me këtë rregull përcaktohen procedurat e krijimit, operimit dhe mirëmbajtjes së një sistemi për lëshimin, transferimin dhe revokimin e Certifikatës së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme, nga mbeturinat, si dhe bashkëgjenerimi i energjisë elektrike dhe termike.

- Projekt-Rregulla për Mbështetje të Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për pranimin në Skemën Mbështetëse.

Me këtë rregull përcaktohet Skema për Mbështetjen e Energjisë Elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme në Kosovë, për të cilat është lëshuar Certifikata e Origjinës. Me këtë Skemë synohet të promovohet prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme, në mënyrë që të përmbushen caqet e përcaktuara nga Ministria e Energjisë dhe Minierave, për konsumin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme.

- Projekt-Procedura për Konsumatorë të Privilegjuar.

Kjo Procedurë është e domosdoshme për hapjen e tregut të energjisë në Kosovë, ku përcaktohet procedura e aplikimit, kriteret për përfitimin e statusit të konsumatorit të privilegjuar dhe procedura e revokimit të atij statusi.

3.1.3 Dokumentet e përgatitura nga ndërmarrjet e licencuara

Dokumentet në vijim janë hartuar nga ndërmarrjet e licencuara dhe janë miratuar nga ZRRE-ja:

- Kodi i Matjes - NQ "Gjakova" Sh.A.

- Kodi i Qasjes në Tokë dhe Ndërtesa - NQ "Gjakova Sh.A.
- Kodi i Matjes- NQ "Termokos" Sh.A.
- Kodi i Qasjes në Tokë dhe Ndërtesa - NQ "Termokos" Sh.A.
- Procedura e Monitorimit të Pajtushmërisë për Indikatorët e Performansës Teknike-KOSTT Sh.A.
- Propozimi për Indikatorët Minimalë të Performansës Teknike -KOSTT Sh.A
- Kodi i Punës për Qasje ne Tokë dhe Ndërtesa i OSSH-së - KEK Sh.A.
- Kodi i Sjelljes dhe Etikës së Korporatës Energjetike të Kosovës - KEK Sh.A.
- Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007 – 2013 - KOSTT Sh.A.
- Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike KEK Sh.A.

3.2 Angazhimi në hartimin e legjislacionit primar

Gjatë vitit 2009 ZRRE është angazhuar dhe ka dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe finalizimin e Projekt Ligjit për Gazin Natyror - Ligji Nr. 03/L-133, që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Gjithashtu ZRRE ka marrë pjesë në Grupin Punues Ndërqeveritar për finalizimin e Projektligjit për Energjinë, Energjinë Elektrike dhe Rregullatorin e Energjisë.

3.3 Burimet e ripërtërishme të energjisë

Aktivitetet kryesore të ZRRE-së gjatë vitit 2009 rreth ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtërishme të energjisë (BRE) në Kosovë janë të lidhura me:

- Ngritjen e infrastrukturës ligjore për kapacitete të reja gjeneruese nga burimet e ripërtërishme, dhe
- Shqyrtimin e aplikacioneve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtërishme.



Fig.3.1. Kapacitet i ri energjetik nga era, 3 x 450 kw, Golesh.

Si rezultat i implementimit të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte, ZRRE ka pranuar aplikacione për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese. Në vazhdim janë paraqitur të dhënat e ndërmarrjeve, të cilave u është lëshuar Autorizimi apo që janë në procedurë e sipër për të marrë Autorizimin.

Tab.3.1. Ndërmarrja së cilës i është lëshuar autorizimi për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga era.

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit	Kapaciteti i instaluar	Lokacioni	Data e lëshimit të Autorizimit
1	"Wind Power" Sh.a	Ndërtimi i gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga era	1.35 MW	Golesh, Harilaq, KK Fushë Kosovë, Republika e Kosovës	29 dhjetor 2009

Sipas tabelës 3.1, shihet se më 29.12.2009, Bordi i ZRRE-së i lëshon Autorizimin e parë ndërmarrjes "Wind Power" Sh.A për projektin për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues që shfrytëzon erën për prodhim të energjisë elektrike, me kapacitet 1.35 MW dhe lejon realizimin e projektit.

Tab.3.2. Ndërmarrjet që kanë aplikuar për të marrë autorizimin për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga era.

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit	Kapaciteti i instaluar	Lokacioni
1	"Wind Power" Sh.A	Ndërtimi i gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga era	900 kW	Bostan, Artanë, Republika e Kosovës
2	Air Energy sh.p.k	Ndërtimi i gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga era	26 MW	Kitkë, KK Gjilan, Republika e Kosovës
3	KOSOVA TER.WINDPARKCOMPANY Sh.p.k	Ndërtimi i gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga era	100 MW	Shtime, Republika e Kosovës

Lidhur me Aplikacionin e ndërmarrjes "Air Energy" sh.p.k, Bordi i ZRRE-së me datë 22.09.2009 ka lëshuar Autorizimin Preliminar, me të cilin kjo ndërmarrje udhëzohet për t'i plotësuar kërkesat e tjera ligjore të domosdoshme për të marrë Autorizimin për ndërtim të këtij gjeneratori.

3.4 Licencimi i ndërmarrjeve të energjisë

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE mund të lëshojë, të modifikojë, të suspendojë dhe të tërheqë licenca për ushtrimin e veprimtarisë nga ndërmarrjet e energjisë dhe, sipas Rregullit për Licencim, ka autoritet të lëshojë licenca për këto aktivitete:

- Gjenerim të energjisë elektrike
- Gjenerim të ngrohjes qendrore
- Furnizim publik me energji elektrike
- Furnizim publik me ngrohje qendrore
- Shpërndarje të energjisë elektrike
- Shpërndarje të ngrohjes qendrore
- Operator të sistemit të transmissioinit
- Operator të tregut
- Furnizim/tregti të energjisë elektrike.

Ndër përgjegjësitë e tjera të ZRRE-së të përcaktuara në Nenin 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë është lëshimi, modifikimi, tërheqja e licencave, si dhe mbikëqyrja e pajtueshmërisë me kushtet e licencës. Mbi bazën e kësaj, gjatë vitit 2009, ZRRE ka kryer një sërë aktiviteteve mbi licencimin e ndërmarrjeve të energjisë.

3.4.1 Lëshimi i licencave

Edhe këtë vit ka vazhduar interesimi i ndërmarrjeve të ndryshme për t'u licencuar, sidomos i tregtarëve në aktivitetin e energjisë. Në tabelën 3.3 është dhënë lista e ndërmarrjeve të cilave ZRRE u ka lëshuar licencë, pas plotësimit të kushteve të parapara në Rregullin për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë.

Tab.3.3. Ndërmarrjet e licencuara në vitin 2009

Nr.	Emri i ndërmarrjes së licencuar	Përshkrimi i aktivitetit të licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	"AKIDU" D.o.o Përfaqësia në Kosovë	Furnizim/tregti me energji elektrike	ERO/Li_31/09	L.Dardania Su 1/5 H.2 Kati 7 Nr.29, Prishtinë, Republika e Kosovës	30.10.2009 deri 30.10.2011
2	"EGL d.o.o.Beograd"-("EGL")	Furnizim/tregti me energji elektrike	ZRRE/Li_32/09	Milutina Milankovica 11 A Beograd, Serbi	29.12.2009 deri 29.12.2011
3	"GEN-I Tirana Sh.p.k"	Furnizim/tregti me energji elektrike	ZRRE/Li_34/09	Ish-Noli Business Center, Rruga Ismail Qemali, nr.27, Tiranë, Shqipëri	29.12.2009 deri 29.12.2011

3.4.2 Vazhdimi i licencave

Të gjitha ndërmarrjeve të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë së licencës me kohë kanë riaplikuar për vazhdim të licencës. Këto ndërmarrje kanë pasur si aktivitet furnizimin/tregtinë me energji elektrike. ZRRE ka vendosur të vazhdojë licencën për ndërmarrjet si në Tab.3.4.

Tab.3.4. Ndërmarrjet të cilave u është vazhduar licenca

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	"ATEL ENERGY AG"	Furnizim/tregti me energji elektrike	ZRRE/Li_35/07	Oltnerstrasse 63, CH-5013, Niedergösgen, Zvicër	31.05.2009 deri 31.05.2011
2	"GSA SHPK"	Furnizim/tregti me energji elektrike	ERO/Li_24/07	"Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall.30 P.O.Box1502,Tiranë, Shqipëri	23.05.2009 deri 23.05.2011
3	"RUDNAP GROUP A.D"	Furnizim/tregti me energji elektrike	ERO/Li_23/07	PC Usce, Mihaila Pupina Boulevard 6/21, 11000 Belgrade-New Belgrade, Serbi	23.05.2009 deri 23.05.2011

3.4.3 Transferi i licencës

ZRRE ka transferuar Licencën për Prodhim të Energjisë elektrike nga ndërmarrja:

- Triangle General Contractors - dega në Kosovë, me adresë Rr."Vëllezërit Gërvalla", ONIX pn. Pejë, Republika e Kosovës, (nr. i licencës ERO/Li_09/06),
në ndërmarrjen:
- "KelKos Energy" SHPK, adresa: Rruga Zagrebi 19/22, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës (nr.i licencës ERO/Li_09/06 - prodhim i energjisë elektrike).

Vlefshmëria e Licencës Triangle General Contractors - dega në Kosovë ishte nga data 04.10.2006 deri 29.04.2024 dhe transferi tani vlen nga data 30.06.2009 deri 29.04.2024.

3.5 Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë

Në kuadër të përmbyshjes së përgjegjësi, të parapara në nenin 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE ka monitoruar/mbikëqyrur të gjitha ndërmarrjet e licencuara. ZRRE, po ashtu, ka monitoruar edhe shthurjen dhe ristrukturimin e aktiviteteve të ndërmarrjeve të energjisë, si dhe pajtueshmërinë e tyre me të gjitha kodet e nxjerra: Rregullat teknike, Rregullat e tregut, Rregulla për qasje në tokë dhe ndërtesa etj.

Ndërmarrjet e licencuara për Prodhim, Shpërndarje, Furnizim Publik dhe Furnizim/tregti të energjisë elektrike; Prodhim, Shpërndarje dhe Furnizim Publik me ngrohje qendrore, dhe ndërmarrja e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë, kanë raportuar në ZRRE në baza të rregullta tremujore dhe vjetore, në përputhje me Doracakun e Raportimit.

Ndërmarrjet e licencuara edhe gjatë këtij viti kanë kërkuar leje për shtyrje afati (derogime) për përmbushjen e disa obligimeve sipas neneve të licencave. ZRRE ka lejuar shtyrje vetëm në ato raste kur kërkesat janë vlerësuar të arsyeshme.

4. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

Gjenerimi, transmissiioni dhe shpërndarja janë komponentët themelore të sistemeve elektro-energjetike. Transmissiioni dhe shpërndarja e energjisë elektrike janë aktivitete të rregulluara dhe bazohen në licencat e lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Në Republikën e Kosovës është i licencuar vetëm një Operator i Sistemit të Transmissiionit dhe Tregut (KOSTT) dhe vetëm një Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike në të gjithë territorin e Kosovës.

4.1 Rrjeti i transmissiionit

Rrjeti i transmissiionit i Kosovës përbëhet nga stabilimente të tri niveleve të tensionit, 400kV, 220kV dhe 110kV. Ky rrjet si zonë elektroenergjetike, përmes linjave ndërlidhëse, është i lidhur me katër shtete fqinje: Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Maqedoninë.

Për një periudhë të gjatë, sidomos prej vitit 1990 deri në vitin 2000, në rrjetin e transmissiionit nuk ka pasur investime e as mirëmbajtje adekuatë. Kjo ka bërë që një numër i linjave dhe i transformatorëve të jenë të mbingarkuar dhe në gjendje jo të mirë operative, duke shkaktuar ndërprerje të shpeshta të furnizimit dhe humbje të mëdha të energjisë elektrike.

Gjatë 10 viteve të fundit është investuar në ngritjen dhe në përmirësimin e kapaciteteve në rrjetin e transmissiionit. Këto investime kanë rritur sigurinë e furnizimit dhe kanë zvogëluar humbjet në transmissiion. Më poshtë është dhënë një listë e shkurtër e investimeve të kryera:

- Instalimi i AT3 në NS 400/220kV, Kosova B
- Rehabilitimi i stabilimenteve shpërndarëse 220kV në Glllogoc
- Ndërrimi i ndërprerësve 110 kV, NS PR1 & NS PR 2
- SCADA lokale në NS KOS B 400/220 kV
- Ndërrimi i mbrojtjeve rele në NS Kos B dhe NS PR 4 dhe sistemin kontrollues
- Përforcimet në linjat transmetuese 110 kV që lidhin NS Kosova A, 220/110 kV me NS Vushtrria dhe NS PZ 1 me NS PZ 2
- Shndërrimi i linjës (nr. 212) 220kV në linjë 110kV
- Projekti NS Peja 3, 400/110kV, 300 MVA
- Instalimi i AT1 në NS 220/110kV, Kosova A
- Linja e re 110kV NS Rahoveci –NS PZ2
- Rivitalizimi i pajisjeve të TL 400kV në NS 400/220 kV, Kosova B
- Ndërrimi i përçuesve në Linjën 110 kV (nr. 126/1), NS Gjakove 1 - NS Deçan
- Autotransformatori AT3 150MVA në NS 220/110 kV, Prishtina 4
- Rivitalizimi i pajisjeve të TL në NS 110/10(20) Prishtina 1

Në vazhdim e sipër janë investimet:

- Rehabilitimi i NS 220/110kV, Kosova A
- SCADA/EMS & Telekom
- ITSMO – Njehsorët (përveç NS Vallaq dhe HC Ujmani ku nuk janë kryer)

Investimet në projektet në vijim janë në fazën fillestare apo përgatitore

- Projekti Ferizaj 2
- Linja ndërlidhëse 400kV Kosovë – Shqipëri

Nga këto investime duhet theksuar posaçërisht ndërtimin e Nënstacionit Peja 3, 400/110 kV, me fuqi 300 MVA, i lëshuar në punë në nëntor 2009, i cili ka ndikuar në eliminimin e ngufatjeve të rrjetit në rajonin e Dukagjinit. Me ndërtimin e këtij nënstacioni është rritur siguria e furnizimit, është përmirësuar kualiteti i tensionit dhe, në masë të madhe, janë zvogëluar humbjet teknike të transmisionit në këtë rajon dhe në rrjet në përgjithësi. Si pjesë e këtij projekti janë paraparë të realizohen edhe investime në stabilimentet që do ta lidhin këtë nënstacion me nënstacionet e tjera ekzistuese.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat bazë për nënstacionet dhe linjat e KOSTT-it sipas nivelit të tensionit.

Tab.4.1. Të dhënat bazë për nënstacionet e KOSTT

Tensioni (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
400/220	KOSTT	1	3	1,200
400/110	KOSTT	1	1	300
220/110	KOSTT	3	7	1,050
220/35	Alferon	1	2	320

Tab. 4.2. Të dhënat bazë për linjat e KOSTT

Tensioni (kV)	Pronari	Gjatësia (km)
400	KOSTT	182
220	KOSTT	232
110	KOSTT	672

Kosova ka një sistem elektroenergjetik relativisht të vogël, por me linja të forta ndërlidhëse me vendet fqinje. Pozita gjeografike e Kosovës bën që nëpër rrjetin transmetues të saj të ketë rrjedha të konsiderueshme të energjisë elektrike. Këto rrjedha kryesisht shkojnë nga veriu në jug të vendit.

Në figurën në vazhdim janë dhënë vlerat e rrjedhave të energjisë në MWh për vitin 2009, për çdo linjë ndërlidhëse në të dy drejtimet (hyrje-dalje).




Fig. 4.1. Rrjedhat e energjisë nëpër linjat ndërlidhëse

Kosova nuk merr pjesë në mekanizmin për kalkulimin e kompensimit ndërmjet OST-ve (ITC mekanizmi), për shkak të problemit me OST-n e Serbisë. Humbjet e shkaktuara nga transiti mbulohen përmes tarifave nga konsumatorët e rregulluar. KOSTT është duke bërë përpjekje të vazhdueshme që të bëhet palë e barabartë në këtë mekanizëm.

Niveli i ngarkimit të rrjetit të transimit mund të shihet edhe nga vlera maksimale e konsumit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pesë vlera të pikut (ngarkesave maksimale), të realizuara në javë të ndryshme gjatë vitit 2009. Ngarkesa më e lartë është regjistruar në dhjetor dhe ka arritur vlerën prej 1051 MWh/h. Nga të dhënat në tabelë vërehet se konsumi më i lartë në rrjetin e transimit të Kosovës ndodh kryesisht në orët e mbrëmjes (18:00 – 23:00), në sezonin e dimrit.

Tab.4.3. Pesë vlerat e pikut në vitin 2009

Piku	MW	Ora	data	Java	Dita
I	1,051	19	13.12.2009	50	E dielë
II	1,050	18	21.12.2009	52	E hënë
III	1,046	21	20.12.2009	51	E dielë
IV	1,006	23	26.11.2009	48	E enjte
V	970	19	14.11.2009	46	E shtunë

Në Fig. 4.2 është paraqitur diagrami ditor i ngarkesës në MWh/h për datën 13 dhjetor 2009 (prodhimi, importi, eksporti, konsumi dhe reduktimet). Në këtë ditë në orën 19:00 dhe 20:00 të mbrëmjes është shënuar konsumi maksimal prej 1072 MWh/h (vlerë e matur nga KOSTT-i para zbritjes së shpenzimeve vetjake të KEK-ut).




Fig.4.2. Diagrami ditor për datën 13.12.2009

Më poshtë është paraqitur diagrami ditor i nxjerr si vlerë mesatare për tërë vitin 2009. Nga diagrami vërehet se prodhimi gjatë 24 orëve ka qenë pothuajse konstant, për dallim nga konsumi i cili ka ndryshuar në intervale kohore.

Gjatë orëve të natës konsumi ka qenë më i ulët, prandaj janë paraqitur teprica të energjisë elektrike, të cilat janë eksportuar, ndërsa prej orës 07:00 të mëngjesit, krahas rritjes së konsumit, janë paraqitur mungesa të energjisë elektrike, të cilat kryesisht janë mbuluar përmes importit apo reduktimeve.




Fig.4.3. Diagrami ditor i nxjerrë si mesatare për 24 orë për vitin 2009

4.2 Rrjeti i shpërndarjes

4.2.1 Struktura e stabilimenteve të rrjetit të shpërndarjes

Rrjeti i shpërndarjes nuk është në gjendje të mirë për shkak të mungesës së investimeve për një periudhë të gjatë, mirëmbajtjes jo të duhur dhe vjetërsisë së një pjese të madhe të tij, andaj humbjet teknike të energjisë në rrjetin e shpërndarjes janë rreth 18%. Rrjeti i shpërndarjes përfshin linjat e niveleve të tensionit 35 kV, 20 kV, 10 kV, 6 kV dhe 04 kV dhe nënstacionet përkatëse. Më poshtë janë dhënë në formë tabelore të dhënat themelore për linjat dhe transformatorët sipas niveleve të tensionit.

Tab. 4.4. Të dhënat bazë të linjave të OSSH-së

Tensioni kV	Pronari	Rrjeti ajror km	Rrjeti kabllor km	Gjatësia km
35	KEK	648.421	26.381	674.802
20	KEK	279.437	165.246	444.683
10	KEK	5,067.763	795.000	5,862.763
6	KEK	44.140	1.580	45.720
0.4	KEK	11,386.866	483.457	11,870.323

Tab.4.5. Numri i nënstacioneve sipas nivelit të tensionit

Tensioni (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
220/35/20	KEK	1	2	80.00
110/35/10(20)	KEK	5	9	249.00
110/35	KEK	7	14	469.50
110/20(10)	KEK	2	4	143.00
110/10	KEK	9	14	441.00
110/35/6.3	Trepça	1	2	63.00
110/35	Trepça	-	2	126.00
110/6.3	Sharri	1	2	40.00
110/35	Ujmani	1	1	20.00
35/10	KEK	52	83	559.80
35/06	Birra Peja	1	1	4.00
35/0.4	KEK	1	1	0.63
(10)20/0.4	KEK	990	1,015	217.34
10/0.4	KEK	5,098	5,258	1,500.88
6/0.4	KEK	35	35	6.68

Investimet e realizuara në periudhën pas vitit 1999 kanë përmirësuar në një masë gjendjen e përgjithshme të rrjetit të shpërndarjes. Megjithatë, për eliminimin e fyteve të ngushta dhe për një furnizim cilësor, nevojiten investime shtesë.

Në vijim janë dhënë investimet kryesore në rrjetin e shpërndarjes të realizuara në periudhën 2000-2009:

Tab.4.6. Nënstacionet e ndërtuara 2000-2009

Nr	Tensioni (kV/kV)	Fuqia (MVA)
1	TS 220/35/10(20) kV Podujeva	2x40
2	TS 110/10(20) kV Berivojce	1x31.5
3	TS 110/10(20) kV Prishtina 5	2x40
4	TS 110/10(20) kV Vushtrria 2	2x31.5
5	TS 110/10(20) kV Peja 2	2x31.5
6	TS 110/10(20) kV Rahoveci	2x31.5

Në investimet në rrjetin e shpërndarjes bëjnë pjesë edhe rehabilitimet apo zgjerimet që janë bërë në dy nënstacione, përkatësisht në NS 110/35 kV/kV (Theranda) dhe NS 110/10 kV/kV (Gjakova 2).

Po ashtu, janë ndërtuar, zgjeruar apo rehabilituar edhe 14 nënstacione në nivelin e tensionit 35/10 kV/kV.

Janë ndërtuar edhe 630 nënstacione 10(20)/04 kV/kV të fuqive të ndryshme (1000 kVA, 630 kVA, 400 kVA, 250 kVA, 160 kVA, 100 kVA dhe 50 kVA), me një fuqi totale të transformimit prej 197 MVA.

Gjatë vitit 2009 janë ndërtuar linja të niveleve të ndryshme të tensionit (ajror apo kabllor); 35 kV me gjatësi 8.5 km, si dhe 10(20) kV me gjatësi rreth 770 km. Gjithashtu edhe në rrjetin 04 kV janë bërë investime të konsiderueshme.

4.3 Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit

Zyra e Rregullatorit për Energji, bazuar në paragrafin 15.2 pika f të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ka kompetencë të përcaktojë standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit që duhen përmbushur nga të licencuarit.

ZRRE në bashkëpunim me MEM dhe të licencuarit si OSSH, OST, FP kanë formuar grupin punues për hartimin e standardeve të cilësisë së furnizimit dhe shërbimit.

Grupi punues është duke punuar, që brenda gjashtëmujorit të parë të viti 2010, të përgatisë dokumentin dhe të propozojë standardet e cilësisë sipas të licencuarve, të cilat pas vlerësimit do të aprovohen nga Bordi i ZRRE-së.

Cilësia e furnizimit dhe e shërbimit të energjisë elektrike përcaktohet nga:

- Kontinuiteti i furnizimit;
- Cilësia e tensionit, dhe
- Cilësia komerciale;

OSSH që nga viti 2006 ka filluar zbatimin e programit (softuerit) për regjistrimin e të gjitha ndërprerjeve të energjisë elektrike që ndodhin në sistem nëpër të gjitha distriktet. Të dhënat janë futur në program në mënyrë manuale, kurse saktësia dhe kompletimi i tyre është rritur gjatë viteve.

4.3.1 Kontinuiteti i furnizimit

Kontinuiteti i furnizimit monitorohet me anë të indekseve siç janë: Indeksi i kohëzgjatjes së ndërprerjeve mesatare në sistem (ang. *System Average Interruption Duration Index - (SAIDI)*), Indeksi i frekuencës të ndërprerjeve mesatare në sistem (ang. *System Average Interruption Frequency Index - (SAIFI)*) dhe Energjia e pafurnizuar (ang. *Energy Not Supplied (ENS)*).

SAIDI është indeks i cili përdoret për matjen e mesatares së kohëzgjatjes së ndërprerjeve, të cilat ndodhin në sistem si rezultat i defekteve. Kjo cilësi matet si indeks vjetor.

Tab. 4.7. Mesatarja vjetore e orëve të humbura të energjisë elektrike sipas distrikteve

Distrikti	Prishtinë	Ferizaj	Gjakovë	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Gjithsej
SAIDI sipas distrikteve	89.34	98.03	148.03	33.19	165.15	57.04	105.44	94.48

SAIFI është po ashtu indeks i cili përdoret për të matur mesataren e shpeshtësisë së ndërprerjeve të konsumatorëve brenda një viti, vlera e të cilit në vitin 2009 është 26.7.

Energjia e pafurnizuar vjetore (*ang. energy not supplied*) e konsumatorëve për shkak të defekteve të cilat kanë ndodhur në rrjetin e operatorit të shpërndarjes është 2.84 GWh.

4.3.2 Cilësia e tensionit

Standardet e cilësisë së tensionit janë të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të furnizimit me energji dhe në Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes së shpërndarjes.

Cilësia e tensionit kryesisht monitorohet përmes regjistrimit të ankesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit.

Sipas kodit të shpërndarjes, OSSh do të operojë me sistemin e shpërndarjes ashtu që të sigurojë që tensioni nëpër терминаlet e sistemit të furnizimit, siç është definuar në standardin IEC 61000, të përputhet me këtë standard. Toleranca e brezit të tensionit të nivelit të ulët do të jetë 230 V, +10%; -15%.

4.3.3 Cilësia komerciale

Cilësia komerciale ndërlidhet me nivelin e performansës së ndërmarrjes, që ka të bëjë me ankesat e konsumatorëve, në përmbushjen e obligimeve nga furnizuesi. Standardet e cilësisë komerciale janë të përfshira në Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, Rregullën për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë dhe Rregullën mbi procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë në Kosovë.

Këto standarde do të jenë obligative dhe atyre do t'u përmbahen të gjithë të licencuarit (OST, OSSH, FP). Monitorimi dhe performansa e të licencuarve kundrejt përmbushjes së këtyre standardeve do të bëhet nga ZRRE.

4.4 Prodhimi i linjitit dhe i energjisë elektrike

4.4.1 Prodhimi i linjitit

Linjiti paraqet rezervën më të madhe dhe kryesore si burim primar i energjisë në Republikën e Kosovës. Linjiti merr pjesë me rreth 98 % të prodhimit të gjithëmbarshtëm të energjisë elektrike në Kosovë. Linjiti i Kosovës ka vlerë të ulët kalorike (mesatarisht 7.8 MJ/kg), por ka mundësi të përshtatshme të eksploatimit të tij.

Dy minierat, Bardhi dhe Mirashi, furnizojnë me linjit termocentralet Kosova A dhe Kosova B, ndërsa një pjesë fare e vogël e linjitit shitet në tregun e lirë.

Prodhimi i linjitit gjatë vitit 2009 ka qenë më i vogël sesa ai i planifikuar me bilancin elektroenergjetik 2009, përderisa konsumi ka qenë më i madh se ai i planifikuar. Në tabelën 4.8 është dhënë prodhimi dhe konsumi i linjitit në vitin 2009.

Tab.4.8. Prodhimi dhe konsumi i linjitit 2009

Prodhimi & Konsumi i Linjitit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Gjithsej prodhimi i linjitit 2009 (t*1000)	633	778	742	533	482	452	558	603	727	734	712	918	7,872
Gjithsej konsumi i linjitit 2009 (t*1000)	805	697	810	512	515	552	539	612	647	713	757	834	7,993

Në figurën në vijim është paraqitur prodhimi dhe konsumi i linjitit sipas viteve 2005 - 2009.




Fig.4.5. Prodhimi dhe konsumi i linjitit 2005 – 2009

4.4.2 Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë është i bazuar kryesisht në energji termike dhe kjo mbulohet nga dy termocentrale: Kosova A dhe Kosova B.

Në prodhimin e energjisë elektrike marrin pjesë edhe HC Ujmani, që funksionon në kuadër të ndërmarrjes "Ibër Lepenc", dhe HC distributiv "Lumbardhi", i dhënë me koncesion nga KEK-u firmës private "KelKos Energy" SHPK.

Njësitë gjeneruese të TC Kosova A dhe TC Kosova B janë lëshuar në punë në faza të ndryshme, si në tabelën e mëposhtme.

Tab.4.9. Kapaciteti i dizajnuar dhe operativ i njësive prodhuese në 2009

Njësitë prodhuese	Viti i lëshimit në punë	Kapaciteti i dizajnuar	Kapaciteti operativ	
		MW	Gjenerator (MW)	Prag (MW)
A1	1962	65	35	32
A2	1964	125	-	-
A3	1970	200	135	120
A4	1971	200	135	120
A5	1975	210	145	130
TC Kosova A		800	450	402
B1	1983	339	290	265
B2	1984	339	280	260
TC Kosova B		678	570	525
HPP Ujmani	1981	35	35	35
HPP Lumëbardhi	1957/2005	8	8	8
Total		1,521	1,063	970

Energjia elektrike e përgjithshme e prodhuar në prag të centraleve në vitin 2009 ka qenë 4,798 GWh, që paraqet një rritje prej 6% krahasuar me vitin 2008.

Prodhimi në prag i TC Kosova A ka qenë 1,424 GWh, që është për 18.93% më i lartë se prodhimi i realizuar në vitin 2008. Pjesëmarrja në prodhimin e përgjithshëm ka qenë 29.68%, ndërsa plani vjetor është realizuar 96.22%.

Tab.4.10. Prodhimi sipas njësive gjeneruese

Prodhimi /Njësitë prodhuese	Total	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh
A1	-6,965	-689	-607	-644	-411	-348	-1,476	-381	-369	-377	-467	-546	-650
A3	650,455	79,682	39,539	75,657	46,766	31,513	75,366	80,232	65,032	72,456	18,273	35,751	30,189
A4	119,516	-3	-5	1,643	-27	-31	-23	-49	-42	-20	-17	32,373	85,717
A5	661,132	56,269	58,798	57,906	35,227	53,127	70,946	66,008	63,736	18,900	76,767	69,698	33,751
TC Kosova A -realizim	1,424,139	135,259	97,725	134,562	81,555	84,261	144,813	145,808	128,358	90,960	94,556	137,275	149,007
B1	1,546,983	166,097	148,822	161,588	105,493	148,816	4,984	89,574	151,579	124,705	156,327	132,184	156,813
B2	1,704,746	172,090	168,655	175,381	106,900	175,467	170,418	81,495	47,694	141,935	140,761	151,223	172,727
TC Kosova B-realizim	3,251,729	338,188	317,476	336,969	212,393	324,283	175,402	171,069	199,273	266,640	297,089	283,407	329,540
HC Ujmani-realizim	88,667	8,095	9,928	10,009	16,339	4,596	4,852	11,193	7,662	3,849	4,289	2,696	5,159
Hc Lumëbardhi-realizim	33,207	2,121	1,593	1,381	5,305	5,157	4,599	3,095	1,102	726	2,356	2,974	2,799
Total Prodhimi-realizim	4,797,743	483,663	426,723	482,921	315,592	418,297	329,666	331,165	336,395	362,175	398,289	426,352	486,506
Total Prodhimi-bilanc	4,712,029	453,971	409,226	452,859	348,392	424,756	292,661	289,211	350,901	392,887	404,006	438,955	454,204
Total prodhimi-realizim/bilanc	102%	107%	104%	107%	91%	98%	113%	115%	96%	92%	99%	97%	107%

Njësitë e TC Kosova B kanë punuar me nivel të lartë të prodhimit (84.45% njësia B1 dhe 84.93% njësia B2). Prodhimi në prag në TC Kosova B ka qenë 3,252 GWh, që përbën 67.78% të prodhimit total të energjisë elektrike, duke realizuar planin vjetor për 103.84%.

Njësia B1 në vitin 2009 ka pasur 33 ndalesa, prej tyre 19 rënie dhe 14 shkyçje. Në remont ka qenë 40 ditë dhe po ashtu ka pasur 2 revizione nga 9 ditë. Njësia B2 ka pasur 14 ndalesa, prej të cilave 10 shkyçje dhe 4 rënie. Në remont ka qenë 40 ditë dhe ka pasur 2 revizione nga 9 ditë.

Gatishmëria funksionale e njësive të TC Kosova B ka qenë rreth 85%, që është e njëjtë me vlerat e parapara në bilancin elektroenergjetik 2009. Me bilancin elektroenergjetik 2009 është paraparë që njësitë e TC Kosova A të jenë në dispozicion 75% të kohës. Kësaj shifre i afrohet vetëm njësia A5 përderisa njësia A4 ka shërbyer kryesisht si kapacitet rezervë.

Energjia e prodhuar në hidrocentrale në vitin 2009 ka qenë 121.9 GWh dhe përbën 2.54% të prodhimit total të energjisë elektrike. HC Ujmani në vitin 2009 ka prodhuar 88.67 GWh, që është 66.25% më i lartë se në vitin 2008, dhe ka tejkaluar prodhimin e parashikuar për 17%, ndërsa prodhimi në HC Lumëbardhi ka qenë 33 GWh.

TC Kosova B ka mbuluar 61.45% të konsumit të përgjithshëm, Kosova A, 26.91%, 2.30% është mbuluar nga hidrocentralet (HC Ujmani dhe HC Lumëbardhi), ndërsa importi, 9.33%.

Pjesëmarrja në përqindje e njësive gjeneruese është paraqitur në grafikun në vijim.




Fig.4.6. Prodhimi sipas njësive gjeneruese në përqindje

Më poshtë është dhënë grafiku i prodhimit gjatë viteve 2000-2009 ku shihet një rritje e vazhdueshme e prodhimit, si rezultat i investimeve në riparimin e njësive gjeneruese.




Fig.4.7. Prodhimi i energjisë elektrike për vitet 2000-2009

4.5 Konsumi i energjisë elektrike

Konsumi i përgjithshëm në vitin 2009 ka qenë 5,275 GWh dhe karakterizohet me një rritje të kërkesës për energji elektrike prej 6.70% në krahasim me vitin 2008.




Fig. 4.8. Konsumi sipas muajve 2009

Ashtu si prodhimi, edhe konsumi i përgjithshëm ka shënuar një rritje të vazhdueshme gjatë viteve 2000-2009, që mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm.




Fig. 4.9. Konsumi i përgjithshëm 2000-2009

Rritja më e ulët e konsumit gjatë dhjetë vjetëve të fundit është shënuar në vitin 2006, me vetëm 0.55 % në krahasim me vitin paraprak, ndërsa rritja më e lartë me 10.36% është shënuar në vitin 2004.

Është me interes të analizohet konsumi sipas kategorive të konsumatorëve, duke përfshirë edhe humbjet teknike dhe komerciale. Një pjesë e konsumatorëve si Ferronikeli, Trepça dhe Sharrceci, janë të kyçur në rrjetin e transmissioinit.

Konsumi i energjisë elektrike sipas kategorive të konsumatorëve për vitin 2009 është dhënë në tabelën 4.11.

Tab.4.11 Konsumi sipas shpenzuesve dhe humbjet e energjisë

Shpenzuesit		2009
		MWh
1	Distribucioni bruto	4,428,053
2	Distribucioni neto	2,532,626
3	Humbjet në teknike	799,137
4	Humbjet komerciale (1-2-3)	1,096,290
5	Trepça+Sharrceci	83,627
6	Ferronikeli	460,415
7	Kosova Thëngjilli+Kons. jashtë KEK	3,257
8	Konsum. intern të KEK +SS Palaj	120,750
9	Humbjet në bartje	174,573
10	Konsumi bruto (1+5+6+7+8+9)	5,270,674

Në rritjen e konsumit ka pasur një ndikim të konsiderueshëm edhe rritja e konsumit të Ferronikelit prej 18% krahasuar me vitin paraprak.

4.5.1 Konsumi në shpërndarje

Konsumi në shpërndarje është rritur për 7.14% krahasuar me vitin 2008.

Në tabelën 4.12 është dhënë konsumi në shpërndarje për vitin 2009 sipas distrikteve.

Tab.4.12. Konsumi në shpërndarje sipas distrikteve 2009

Distriktet	Ngarkimi 2009	Pjesëmarrja në total
	GWh	
Prishtina	1,302,725	29.42%
Mitrovica	649,063	14.66%
Peja	507,930	11.47%
Gjakova	280,174	6.33%
Prizreni	733,736	16.57%
Ferizaji	562,733	12.71%
Gjilani	391,691	8.85%
Total shpërndarja	4,428,053	100.00%

Konsumi më i lartë është arritur në distriktin e Prishtinës, me 29.42% të konsumit total në shpërndarje, ndërsa konsumin më të ulët e ka pasur distrikti i Gjakovës me 6.33%.

Konsumi në distriktin e Prizrenit është rreth 1% më i ulët në vitin 2009 krahasuar me vitin paraprak, për shkak se nga tetori 2009 komuna e Rahovecit dhe e Malishevës kanë kaluar në distriktin e Gjakovës.

Në tabelën 4.13 janë dhënë shënimet për konsumin sipas kategorive të konsumatorëve në baza mujore në nivelin e shpërndarjes dhe konsumatorëve të kyçur në nivelin 110 kV.

Tab.4.13. Konsumi sipas kategorive tarifore në vitin 2009

MWh	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali	Pjesëmarrja në Konsum
110kV (Trepça + Sharrcem)	3,104	5,770	7,585	8,154	8,148	6,377	7,389	7,837	7,779	7,514	7,838	6,131	83,627	3.20%
35 kV	4,851	5,359	3,564	3,172	2,783	2,993	2,528	2,561	2,535	2,245	2,607	3,419	38,616	1.48%
10 kV	17,439	18,997	16,977	14,461	13,943	14,700	13,156	16,409	13,842	14,308	16,644	17,988	188,862	7.22%
Amvisëria nën 200 kWh/muaj dhe Spitalet	43,617	43,947	44,227	45,093	45,297	46,676	47,081	47,856	48,174	48,477	50,061	50,402	560,908	21.44%
Amvisëria prej (201kWh deri ne 600kWh)/muaj	55,170	56,275	54,501	53,672	51,378	53,469	47,339	51,721	55,349	56,147	66,045	65,249	666,314	25.47%
Amvisëria mbi 600 kWh/muaj	58,848	61,719	50,838	39,011	30,344	30,732	19,269	24,027	27,274	30,498	55,672	56,347	484,578	18.52%
0.4 kV I	14,360	17,359	12,945	12,827	12,656	13,984	13,620	14,700	18,015	13,774	16,951	16,687	177,877	6.80%
0.4 kV II	32,725	32,749	31,111	27,028	24,953	27,241	23,891	27,435	25,301	27,265	36,128	34,207	350,033	13.38%
Ndriçimi publik	599	727	559	567	557	548	457	525	697	959	1,226	1,094	8,514	0.33%
Konsumatorët në amvisëri pa njëjtor	6,335	6,271	6,216	6,170	5,565	4,037	3,913	3,921	3,855	3,786	3,749	3,104	56,923	2.18%
Total	237,049	249,173	228,522	210,155	195,623	200,756	178,643	196,992	202,820	204,973	256,921	254,627	2,616,253	100%

Amvisëria (konsumatorët familjarë) ka pjesëmarrje më të lartë (57.42%) në konsumin e përgjithshëm.




Fig. 4.10. Pjesëmarrja e grupeve tarifore në realizimin total 2009

Konsumi në shpërndarje për 10 vitet e fundit ka shënuar rritje mesatare rreth 6%. Rritje më e theksuar është shënuar në vitin 2001 me 13% (figura 4.11), ndërsa rritja më e ulët është shënuar në vitin 2006 me 0.5% në raport me vitin paraprak.




Fig.4.11. Konsumi në shpërndarje ndër vite

4.6 Furnizimi i konsumatorëve me energji elektrike sipas skemës ABC

Gjatë vitit 2009 furnizimi me energji elektrike ka qenë më i mirë krahasuar me vitin 2008, megjithatë në raste të caktuara të mungesës së energjisë elektrike furnizimi është bërë sipas skemës së kategorizimit ABC. Sipas kësaj skeme furnizim më të mirë kanë konsumatorët e kategorisë A, të cilët janë pagues të rregullt të energjisë elektrike, dhe në daljet furnizuese të tyre regjistrohen humbje më të vogla komerciale, ndërsa furnizim më të reduktuar kanë konsumatorët e kategorive B dhe C, të cilët nuk janë pagues të rregullt të energjisë elektrike dhe në dalje të tyre regjistrohen humbje më të mëdha komerciale.

4.7 Humbjet e energjisë elektrike

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e Kosovës janë mjaft të larta dhe paraqesin problem shqetësues për sektorin e energjisë elektrike dhe për ekonominë e vendit në përgjithësi.

Në vitin 2009 gjithsej humbjet teknike kanë qenë 18.3%, ndërsa ato komerciale 20.8% të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike.

4.7.1 Humbjet e energjisë elektrike në transmision

Humbjet e energjisë elektrike në transmision për vitin 2009 kanë qenë 175 GWh, që shprehur në përqindje është 3.32% të konsumit të përgjithshëm. Në humbjet totale të OST-së janë përfshirë edhe humbjet e shkaktuara për shkak të tranzitit (rreth 1% e energjisë elektrike të tranzituar).

Tab.4.14. Humbjet në transmision për vitin 2009

Muajt	Njësitë	Totali	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Djetor
Konsumi i përgjithshëm	MWh	5,275,108	577,414	524,405	527,458	391,435	356,843	326,341	339,399	347,585	353,022	450,312	509,924	570,969
Humbjet në transmision	MWh	174,573	22,452	20,194	20,270	12,332	12,878	9,438	8,720	10,061	9,817	14,622	13,021	20,768
Humbjet në transmision	%	3.31	3.89	3.85	3.84	3.15	3.61	2.89	2.57	2.89	2.78	3.25	2.55	3.64

Humbjet në transmision gjatë viteve kanë ndryshuar, mirëpo nga viti 2006 vërehet një zvogëlim gradual, nga 6.54% sa ishin në 2006, në 3.32 % në vitin 2009. Investimet e realizuara nga KOSTT-i në rrjetin e transmisionit kanë ndikuar në uljen e këtyre humbjeve.

Tab.4.15. Humbjet në transmision 2000-2009

Vitet	Konsumi i Përgjithshëm	Humbjet	
	GWh	GWh	%
2000	2,835	199	7.02
2001	3,105	122	3.93
2002	3,312	185	5.59
2003	3,541	114	3.22
2004	3,908	170	4.35
2005	4,259	276	6.48
2006	4,283	280	6.54
2007	4,576	267	5.83
2008	4,944	215	4.35
2009	5,275	175	3.32
Total	40,038	2,003	5.00

Deri në vitin 2006 nuk ka pasur evidenca të veçanta për humbjet në transmision, prandaj për këto vite janë marrë vlera të përafërta, ndërsa nga viti 2006 humbjet në transmision janë llogaritur si ndryshim i vlerave të matura të energjisë në hyrje dhe dalje të transmisionit.

4.7.2 Humbjet në shpërndarje

Humbjet e energjisë elektrike në shpërndarje paraqesin problemin kryesor të vetëqëndrueshmërisë financiare të Divizionit të Furnizimit dhe të Shpërndarjes.

Në tabelën 4.16 janë paraqitur humbjet teknike dhe komerciale sipas distrikteve për vitin 2009:

Tab.4.16. Humbjet në shpërndarje sipas distrikteve për vitin 2009

Distriktet	Ngarkimi	Realizimi	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet totale	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Prishtina	1,302,725	805,775	184,800	14.19	312,151	23.96	496,950	38.15
Mitrovica	649,063	204,482	132,801	20.46	311,780	48.04	444,581	68.50
Peja	507,930	295,185	99,668	19.62	113,077	22.26	212,745	41.88
Gjakova	280,174	180,538	48,556	17.33	51,080	18.23	99,636	35.56
Prizreni	733,736	455,004	159,803	21.78	118,929	16.21	278,732	37.99
Ferizaji	562,733	320,798	109,307	19.42	132,628	23.57	241,935	42.99
Gjilani	391,691	270,845	64,202	16.39	56,645	14.46	120,846	30.85
Total shpër.	4,428,053	2,532,626	799,137	18.05	1,096,290	24.76	1,895,427	42.80

Nga tabela vërehet se humbjet komerciale në distriktin e Mitrovicës me 48% janë dukshëm më të larta se në distriktet e tjera, që është si pasojë e pamundësisë së faturimit dhe arkëtimit nëpër enklava.

Humbjet e përgjithshme në shpërndarje kanë qenë 1 895 GWh, ose në përqindje 42.80% të energjisë së futur në shpërndarje. Humbjet teknike në vitin 2009 kanë qenë 799 GWh, ose 18.05 %, kurse humbjet komerciale 1 096 GWh ose 24.76%.

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur humbjet në përqindje, krahasuar me energjinë e faturuar.




Fig. 4.12. Energjia e faturuar dhe humbjet në shpërndarje

Humbjet në shpërndarje gjatë dhjetë viteve të kaluara kanë qenë mjaft të larta, me pjesëmarrje mesatare prej 45.14 % ndaj konsumit të përgjithshëm në shpërndarje.

Tab.4.17. Humbjet në shpërndarje për vitet 2000-2009

Vitet	Ngarkimi	Realizimi	Humbjet totale	
	MWh	MWh	MWh	%
2000	2,590,594	1,391,482	1,199,112	46.29
2001	2,936,950	1,555,253	1,381,697	47.05
2002	3,085,929	1,912,829	1,173,100	38.01
2003	3,359,823	1,962,519	1,397,304	41.59
2004	3,665,742	1,956,097	1,709,645	46.64
2005	3,800,852	1,929,936	1,870,916	49.22
2006	3,821,408	1,973,126	1,848,282	48.37
2007	4,031,213	2,092,057	1,939,156	48.10
2008	4,132,783	2,363,281	1,769,502	42.82
2009	4,428,053	2,532,626	1,895,427	42.80
Total	35,853,346	19,669,206	16,184,140	45.14

4.8 Faturimi dhe arkëtimi

Energjia elektrike e faturuar dhe e arkëtuar ka shënuar rritje në vitin 2009. Raporti arkëtim/faturim për vitin 2008 ka qenë 71.87%, ndërsa për vitin 2009 ky raport është 79.70%, që do të thotë se arkëtimi është rritur për 7.83% në krahasim me vitin paraprak.

Tab.4.18. Faturimi dhe arkëtimi sipas distrikteve për vitin 2009

Distriktet	Ngarkimi	Faturimi	Faturimi	Arkëtimi	Raporti
	kWh	kWh	Euro	Euro	Ark/fat
Prishtina	1,302,725	805,775	58,197,763	50,773,744	87.24%
Mitrovica	649,063	204,482	14,370,888	8,957,886	62.33%
Peja	507,930	295,185	21,049,192	17,508,703	83.18%
Gjakova	280,174	180,538	12,271,039	9,428,877	76.84%
Prizreni	733,736	455,004	31,277,732	25,403,361	81.22%
Ferizaji	562,733	320,798	22,824,627	16,304,471	71.43%
Gjilani	391,691	270,845	18,304,482	13,733,067	75.03%
Total shpër.	4,428,053	2,532,626	178,295,723	142,110,110	79.70%

Në shumën e përgjithshme të arkëtitimit të paraqitur në tabelën e mësipërme nuk është përfshirë arkëtimi i konsumatorëve të kyçur në transimion si Ferronikeli, Trepça dhe Sharrceci. Shuma e përgjithshme e këtyre konsumatorëve është 25,323,204 €.




Fig.4.13. Arkëtimi sipas distrikteve

Distrikti i Prishtinës ka realizuar 35.7% të arkëtimit total në shpërndarje, ndërsa më së paku në arkëtimin e përgjithshëm ka kontribuar distrikti i Mitrovicës me vetëm 6.3%.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur faturimi, arkëtimi dhe raporti arkëtim/faturim gjatë viteve 2000 – 2009, prej ku shihen luhatjet e nivelit të arkëtimit.




Fig.4.14. Faturimi dhe arkëtimi 2000-2009

4.9 Tregu i energjisë elektrike

Nënshkrimi i Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si rezultat i procesit të Athinës, ka ndikuar në reformimin e të gjitha niveleve të sektorit të energjisë elektrike në Kosovë, si nga aspekti institucional, juridik dhe rregullativ, e deri te niveli operativ.

Për hapjen e tregut rëndësi të posaçme ka shthurja e kompanive vertikalisht të integruara. Hapi i parë i realizuar në këtë drejtim në Kosovë ka qenë në vitin 2006, me ndarjen e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut nga KEK-u. Procesi i shthurjes së KEK-ut është në vazhdim e sipër dhe pritet privatizimi i shpërndarjes dhe furnizimit.

Në hapjen e tregut rëndësi të veçantë ka krijimi i kushteve për marrjen e statusit të privilegjuar nga konsumatorët. Nga janari 2009, Ministria e Energjisë dhe Minierave ka lëshuar udhëzimin administrativ me të cilin iu mundësohet të gjithë konsumatorëve të kyçur në tension 10kV e më lart të kenë të drejtë të fitojnë statusin e konsumatorit të privilegjuar. Ndërsa, në gusht 2009, MEM ka lëshuar një udhëzim të ri administrativ me të cilin të drejtën e konsumatorit të privilegjuar mund ta fitojnë të gjithë konsumatorët jofamiljarë.

4.9.1 Rrjedhat e energjisë elektrike 2009

Tregu i realizuar i energjisë elektrike në Kosovë në vitin 2009 është paraqitur në figurën e mëposhtme, duke përfshirë gjenerimin, importin, eksportin, tregtarët me shumicë, transmisionin, shpërndarjen, furnizimin, konsumatorët e rregulluar dhe ata të privilegjuar, si dhe tranzitin. Rrjedhat e energjisë elektrike në figurë janë dhënë me vlera fizike në GWh. Kosova në vitin 2009 ka qenë neto importuese e energjisë elektrike.




Fig.4.15. Rrjedhat e energjisë elektrike 2009

4.9.2 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

Në mënyrë që të mbulohet konsumi gjatë ngarkesave maksimale (pikut), si dhe gjatë remonteve të gjeneratorëve, me bilanc elektroenergjetik parashihet që të importohet një sasi e caktuar e energjisë elektrike. Po ashtu, me bilanc elektroenergjetik është paraparë që në tarifën e ulët, në një pjesë të vitit të paraqiten teprica të energjisë elektrike, të cilat mund të eksportohen. Kjo sasi e importit dhe eksportit është realizuar përmes tenderëve të shpallur gjatë vitit 2009, si dhe përmes kontratave dhe aneks kontratave nga tenderët paraprakë nga viti 2008.

Importi i KEK-ut gjatë vitit 2009 është realizuar në formë shkëmbimi të energjisë elektrike, si dhe përmes kontratave të lidhura me tregtarët. Çmimet e importit në kuartalin e parë kanë qenë shumë të larta dhe silleshin nga 109.50 €/MWh – 143.55 €/MWh, ndërsa në kuartalin e dytë vërehet një ulje e çmimeve të importit deri në 62.2%, kundrejt kuartalit të parë. Në këtë kanë ndikuar shumë faktorë që kryesisht janë rajonalë, por edhe si rezultat i importit nga kontratat e lidhura sipas tenderit të vitit paraprak, kur çmimet kanë qenë tepër të larta. Gjatë pjesës së dytë të vitit 2009 vërehet një stabilizim i çmimeve të importit.




Fig. 4.16. Importi i energjisë elektrike dhe çmimi gjatë vitit 2009

Energjia elektrike e importuar me kontrata gjatë vitit 2009 ka qenë 610,509 MWh, me vlerë prej 46,256,119.48 €. Çmimi mesatar ka qenë 75.77 €/MWh. Në krahasim me vitin 2008, në vitin 2009 është shënuar një rritje e sasisë së energjisë së importuar me kontrata për 33.35%, ndërsa është shënuar një ulje e çmimeve për 32.67%. Përveç kësaj, gjatë të njëjtës periudhë KEK-u ka importuar energji në formë shkëmbimi. Shkëmbimi është marrë kryesisht me koeficient kthimi 1:1 në të njëjtën periudhë dhe tarifë, por ka pasur një sasi të vogël me koeficient 1:1.1. Pjesa më e madhe e shkëmbimit është realizuar me Shqipërinë (KESH). Shkëmbimi (si import) është 157,033 MWh. Neto importi është rritur për 19.64 % në krahasim me vitin 2008.




Fig.4.17. Eksporti i energjisë elektrike dhe çmimi gjatë vitit 2009

Me gjithë mungesën e energjisë në Kosovë, ekzistojnë periudha kur paraqiten teprica, sidomos në sezonin veror në tarifën e ulët.

Sasia totale e energjisë elektrike e eksportuar nga KEK-u gjatë vitit 2009 ka qenë 113,910 MWh, me çmim mesatar prej 20.17 €/MWh. Kjo sasi e eksportit i ka sjellë KEK-ut të ardhura prej 2,297,294.6 €.

Çmimet e eksportit janë shumë më të ulëta se ato të importit. Arsye kryesore për çmimin e ulët të eksportit është se ai është realizuar kryesisht në tarifën e ulët, prej orës 00:00-07:00.

Eksporti në formë shkëmbimi në këtë periudhë ka qenë 159,815 MWh. Dallimi mes eksportit dhe importit në formë shkëmbimi është i vogël (3,072 MWh) dhe KEK-u gjatë vitit 2009 ka pasur bilanc pozitiv të shkëmbimit të energjisë elektrike. Vlen të theksohet se gjatë muajve maj, qershor dhe shtator, KEK-u ka pasur më shumë eksport sesa import.

Tab.4.19. Shkëmbimi, eksporti dhe importi i energjisë elektrike për vitin 2009

Muaji	Import			Eksport			Shkëmbim			Total		
	Sasia MWh	Çmimi (€/MWh)	Vlera (€)	Sasia MWh	Çmimi (€/MWh)	Vlera (€)	Marrje MWh	Dhënie MWh	Ndrysh. MWh	Marrje MWh	Dhënie MWh	Ndryshimi MWh
1	84,321	126.10	10,632,844.90	0		0.00	33,730	17,670	-16,060	118,051	17,670	-100,381
2	79,940	125.78	10,054,845.50	0		0.00	15,980	210	-15,770	95,920	210	-95,710
3	37,490	102.53	3,843,862.13	0		0.00	16,420	6,672	-9,748	53,910	6,672	-47,238
4	22,464	38.90	873,849.60	4,870	16.04	78,133.50	63,521	0	-63,521	85,985	4,870	-81,115
5	4,100	50.18	205,717.50	44,155	18.70	825,626.70	0	22,582	22,582	4,100	66,737	62,637
6	23,965	44.84	1,074,492.50	21,085	18.60	392,236.55	0	8,138	8,138	23,965	29,223	5,258
7	32,095	50.75	1,628,874.90	9,555	22.05	210,728.35	2,400	16,592	14,192	34,495	26,147	-8,348
8	37,884	59.06	2,237,492.92	2,400	26.81	64,344.00	0	18,872	18,872	37,884	21,272	-16,612
9	30,610	53.39	1,634,145.40	16,900	24.63	416,262.00	0	22,302	22,302	30,610	39,202	8,592
10	79,700	50.99	4,063,659.10	4,480	29.23	130,928.00	240	23,385	23,145	79,940	27,865	-52,075
11	85,120	59.36	5,052,951.18	3,185	18.45	58,761.50	15,122	11,380	-3,742	100,242	14,565	-85,677
12	92,820	53.37	4,953,383.85	7,280	16.52	120,274.00	9,620	12,302	2,682	102,440	19,582	-82,858
Total	610,509	75.77	46,256,119.48	113,910	20.17	2,297,294.60	157,033	160,105	3,072	767,542	274,015	-493,527

Importi i energjisë elektrike gjatë viteve 2000-2009 ka pasur ngritje dhe rënie, por çmimet gjithnjë kanë shënuar rritje, përveç në vitin e fundit.

Gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare, KEK-u ka importuar sasinë e energjisë elektrike me kontrata prej 5,477 GWh.

Tab.4.20. Sasia, çmimi dhe vlera e importit të KEK-ut në periudhën 2000–2009

KEK Import	Sasia	Çmimi	Vlera
Viti	MWh	(\$)/€/MWh	mil Euro
2000*	778,870	30.43	23.70
2001*	921,485	29.60	27.28
2002*	627,265	32.67	20.49
2003	314,794	44.53	14.02
2004	483,580	39.64	19.17
2005	349,335	47.87	16.72
2006	393,054	54.87	21.30
2007	539,812	83.66	45.16
2008	457,817	112.52	51.51
2009	610,509	75.77	46.30
Total	5,476,521	52.20	285.65

*Shënim: Në 2000-2002 çmimet janë në dollarë amerikanë-US\$ me një normë shkëmbimi me € përafërsisht 1:1

Sasia e eksportuar gjatë 10 viteve ka qenë 530,224 MWh, me çmim mesatar prej 33.74 €/MWh. Duhet të ceket se nga viti 2000 deri 2005, tërë sasia e energjisë elektrike e eksportuar është realizuar si shkëmbim me koeficientë të ndryshëm të kthimit.

Tab.4.21. Eksporti i energjisë elektrike 2000-2009

KEK Export	Eksport	Çmimi Eksp	Vlera
Viti	MWh	€/MWh	mil Euro
2000	1,440		
2001	236,190		
2002	552,783		
2003	279,510		
2004	191,665		
2005	40,690	29.60	1.20
2006	80,172	40.70	3.26
2007	170,175	38.45	6.54
2008	125,277	36.59	4.58
2009	113,910	20.17	2.30
Total	530,224	33.74	17.88




Fig.4.18. Importi dhe eksporti 2000-2009

Në grafikun e mësipërm është paraqitur sasia e importit dhe e eksportit, si dhe çmimi i tyre i realizuar gjatë 10 vjetëve të fundit. I gjithë importi i paraqitur në grafik është import me kontrata, përderisa eksporti deri në vitin 2005 është si shkëmbim, ndërsa nga ky vit është me kontrata.

4.9.3 Krahاسimi i çmimeve të importit me vendet e rajonit

Çmimet e importit të KEK-ut për tremujorin e parë kanë qenë mjaft të larta në krahasim me ato të rajonit, përderisa gjatë pjesës tjetër të vitit ato janë normalizuar dhe pothuajse kanë qenë të njëjta.

Çmimet e importit të arritur nga KEK-u, krahasuar me çmimet e tregtisë një-ditë-para (day ahead), çmimet brenda ditës (intraday-EEX) apo të tregtisë dypalëshe (bilaterale) në disa tregje evropiane janë një tregues i mirë për të analizuar variacionet e çmimeve.

Tab.4.22. Çmimet një ditë përpara (apo me kontrata) të rajonit ndaj çmimeve të importit të KEK-ut

2009	EEX		DESMIE		OPCOM		IPEX		APX		KEK-Import	
	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh	MWh	€/MWh
Janar	252,685	70.85	4,349,318	67.47	525,369.00	34.06	27,071,149	83.45	2,289,138	57.53	84,321.00	126.10
Shkurt	225,058	57.67	3,976,552	60.58	454,406.00	32.98	24,984,931	76.95	1,869,146	48.63	79,940.00	125.78
Mars	300,939	41.09	4,081,200	57.27	593,800.00	30.32	26,685,863	69.10	2,345,392	36.96	37,490.00	102.53
Prill	344,708	37.86	3,599,427	45.32	500,778.00	24.25	24,339,903	58.36	2,229,265	34.60	22,464.00	38.90
Maj	382,093	35.93	3,902,306	49.41	572,226.00	34.50	24,998,492	58.51	2,473,973	30.74	4,100.00	50.18
Qershor	409,798	39.39	4,351,115	45.79	615,707.00	33.61	25,103,967	51.82	2,529,014	34.00	23,965.00	44.84
Korrik	522,004	34.42	5,158,984	48.20	635,792.00	36.50	28,670,111	60.50	2,485,590	34.10	32,095.00	50.75
Gusht	527,239	38.49	4,528,929	46.91	495,064.00	36.85	23,600,054	71.07	2,471,630	35.59	37,884.00	59.06
Shtator	562,653	43.05	3,934,258	49.73	443,301.00	42.68	26,688,855	66.49	2,354,576	38.42	30,610.00	53.39
Tetor	695,689	43.06	3,899,398	54.22	489,447.00	45.95	28,117,122	57.63	2,511,150	45.73	79,700.00	50.99
Nëntor	654,808	39.87	3,901,467	48.58	460,230.00	28.82	26,444,819	53.93	2,713,435	36.11	85,120.00	59.36
Dhjetor	793,743	39.13	4,223,034	49.52	552,475.00	38.51	26,719,000	57.39	2,773,102	38.03	92,820.00	53.37
Totali	5,671,417	43.40	49,905,988	51.92	6,338,595.00	34.92	313,424,266	63.77	29,045,411	39.20	610,509.00	75.77

Për rajonin janë të paraqitura çmimi dhe sasia e energjisë bazë (00-24h) dhe këto shënime janë të ndryshme, varësisht nga palët, p.sh. DESMIE (Greqia) dhe IPEX (Itali) kanë sasinë dhe çmimin për tërë energjinë e transmetuar. Importi i realizuar nga KEK-u është kryesisht energji e moduluar (orët e pikut).

Çmimet rajonale dhe krahasimi me çmimet e KEK-ut janë ilustruar edhe në diagramin më poshtë.




Fig. 4.19. Diagrami i çmimit në rajon dhe importit të KEK-ut gjatë vitit 2009

4.10 Shqyrtimi i tarifave të energjisë elektrike

Përcaktimi i tarifave dhe çmimeve vazhdon të mbesë një nga sfidat themelore të rregullatorëve në përgjithësi. Në ekonominë moderne të kësaj kohe, kostoja e energjisë është pjesë përbërëse e pothuajse të gjitha produkteve të plasuara në treg dhe, si e tillë, luan rol të rëndësishëm në koston e prodhimit të këtyre produkteve që në mënyrë direkte ndikon në çmimin e shitjes së tyre. Kështu, çdo lëvizje e çmimit të energjisë reflektohet në mënyrë zinxhirore edhe në çmimet e produkteve të tjera. Kjo e bën përcaktimin e tarifave një ndër funksionet shumë të rëndësishme të ZRRE-së.

4.10.1 Shqyrtimi i tretë i tarifave të energjisë elektrike

Gjatë vitit 2009 ZRRE ka iniciuar shqyrtimin e tretë me radhë të tarifave të energjisë elektrike. Ky shqyrtim ka për qëllim vlerësimin e të Hyrave të Lejuara të nevojshme për funksionimin normal të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK) dhe të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës sh.a. (KOSTT).

Fillimisht, ZRRE ka dërguar parimet dhe orarin e shqyrtimit tarifar, sipas të cilit të licencuarit e kanë dorëzuar aplikacionin preliminar. Pas komenteve të ZRRE-së lidhur me aplikacionin preliminar, të licencuarit i kanë dorëzuar aplikacionet finale, për të cilat është përpiluar Raporti Konsultativ. Komente rreth Raportit Konsultativ, përveç të licencuarve, kanë dërguar edhe palët e tjera të interesit. Pas marrjes në konsideratë të këtyre komenteve, ZRRE-ja ka marrë vendimin përfundimtar për nivelin e të Hyrave të Lejuara dhe për tarifa. Procesi i shqyrtimit të tretë tarifar është dhënë në figurën në vijim:



Fig. 4.20. Procesi i shqyrtimit të Tretë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE3)

4.10.2 Përcaktimi i tarifave të energjisë elektrike

ZRRE ka shqyrtuar aplikacionet për të Hyra të Lejuara dhe Tarifa të të licencuarve, bazuar në legjislacionin sekondar të ZRRE-së, përkatësisht në Rregullën e Çmimeve dhe në Metodologjinë Tarifore. Këto dy dokumente paraqesin parimet dhe metodologjinë e llogaritjes së të Hyrave të Lejuara, të cilat duhet të mbledhen nga tarifat e rregulluara. Një përmbledhje e mënyrës së llogaritjes së të Hyrave të Lejuara është dhënë në figurën në vijim:




Fig. 4.21. Llogaritja e të Hyrave të Lejuara për kompanitë e rregulluara

Siç mund të shihet nga Figura 4.28, të Hyrat e Lejuara të kompanive të rregulluara duhet të përfshijnë shpenzimet e arsyeshme operative, të cilave u shtohen, përveç investimeve kapitale,¹ edhe kostot e blerjes së energjisë nga importi, kostot e humbjeve dhe kostot e alokuara të Administratës Qendrore². Shuma e këtyre kostove përbën të ashtuquajturën “Koston e Lejuar” të cilës i zbriten të Hyrat që KEK-u përfiton nga subvencionet, nga eksporti dhe nga aktivitetet e parregulluara. Të Hyrat e Lejuara të llogaritura në këtë mënyrë duhet të mbledhen nga tarifat e konsumatorëve të rregulluar. Kjo metodologji është zbatuar për llogaritjes e të Hyrave të Lejuara dhe për vlerësimin e aplikacioneve të KEK-ut dhe të KOSTT-it të dorëzuara në kuadër të SHTE3. Pas vlerësimit të detajuar të këtyre aplikacioneve, ZRRE ka konstatuar se, për t’u arritur niveli i llogaritur i të Hyrave të Lejuara, tarifat për vitin 2009 duhet të rriten mesatarisht për 2.5% krahasuar me tarifat e vitit 2008.




Fig. 4.22. Krahasimi i të Hyrave të Lejuara dhe Tarifave të vitit 2008 dhe 2009

¹ Në kuadër të kostove të kësaj kategorie hyjnë kostot e zhvlerësimit të aseteve dhe kostot e kthimit të lejuar.

² Vlen vetëm për KEK-un.

Kjo rritje e tarifave të energjisë elektrike ka bërë që fatura mujore e konsumatorit mesatar që konsumon përafërsisht 600 kWh energji elektrike të rritet për 63 centë në verë dhe për 88 centë në dimër, që konsiderohet të simbolizojë vlerë të përballueshme për konsumatorin mesatar. Megjithatë, për të siguruar përballueshmërinë e faturave nga konsumatorët në nevojë, ZRRE ka vazhduar së implementuari sistemin e tarifave me blloqe.

4.10.3 Tarifa me Blloqe

Përballueshmëria e tarifave të energjisë elektrike mbetet sfida e cila mund të jetë më e shprehur në Kosovë krahasuar me vendet e rajonit, për shkak të nivelit të theksuar të varfërisë. Duke pasur parasysh këtë, ZRRE ka vazhduar së implementuari tarifën me blloqe që është praktikë e zakonshme e shteteve të cilat synojnë të zbusin problemin e përballueshmërisë së faturave të energjisë elektrike.

Tarifa me blloqe është sistem tarifar që, përveç inkurajimit të konsumit efikas të energjisë elektrike, u mundëson konsumatorëve në nevojë, apo konsumatorëve me të ardhura të ulëta, të konsumojnë një nivel të domosdoshëm të energjisë elektrike me çmim më të ulët, që në të shumtën e rasteve është nën koston e furnizimit me energji elektrike. Në këtë mënyrë, konsumatori paguan tarifë më të ulët për një nivel të caktuar të konsumit të energjisë elektrike (që në Kosovë është nën 200 kWh në muaj), tarifë kjo që rritet krahas rritjes së konsumit të energjisë elektrike. Ky sistem tarifar parasheh që tarifa që është nën koston e furnizimit për konsumatorët e bllokut të parë dhe bllokut të dytë, të mbulohet nga tarifa që është mbi koston e furnizimit për konsumatorët e bllokut të tretë që konsumojnë mbi 600 kWh energji elektrike në muaj. Ky sistem tarifar është paraqitur figurativisht në vijim:




Fig. 4.23. Blloqet tarifore

4.10.4 Parimi i shpërndarjes së kostos

Vlerësimi i të Hyrave të Lejuara që konsiderohen të domosdoshme për funksionimin normal afarist të kompanive të rregulluara përbën vetëm pjesën e parë të shqyrtimit tarifar. Pjesa tjetër, dhe më sfiduesja, është alokimi (shpërndarja) i kostove të lejuara në kategoritë e kostove dhe pastaj në nivele të ndryshme të tensionit. Kostot e lejuara të kompanive të rregulluara ndahen në tri kategori kryesore:

- Kostot e lidhura me konsumatorin
- Kostot e lidhura me energjinë
- Kostot e lidhura me ngarkesën


Këto tri kategori të kostove ndahen në nivele të ndryshme të tensionit, proporcionalisht me kostot reale të furnizimit me energji elektrike të secilit nivel tensioni. Për këtë arsye, tarifa e shërbimit të secilës kategori të konsumatorëve ndryshon varësisht prej kostos së furnizimit me energji të asaj kategorie të konsumatorëve.

Tab.4.23. Alokimi i të hyrave të lidhura me konsumatorin, energjinë dhe kërkesën për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve

		Kosto për Konsumatorë	Kosto për Ngarkesë	Kosto për Energji	Gjithsej
0. Kategoria - 110 kV	€000	2	979	2,087	3,069
1. Kategoria - 35 kV	€000	3	387	1,056	1,447
2. Kategoria - 10 kV (20 kV)	€000	16	2,345	4,640	7,001
3. Kategoria I - 0.4 kV - komercial me fuqi reaktive	€000	829	4,201	5,952	10,982
4. Kategoria II - 0.4 kV komercial pa fuqi reaktive	€000	1,209	7,430	6,943	15,583
5. Kategoria 0.4 kV shtëpiak 2 tarifor	€000	7,851	38,485	40,488	86,825
6. Kategoria 0.4 kV shtëpiak 1 tarifor	€000	1,633	3,825	4,024	9,483
7. Kategoria 0.4 kV shtëpiak pa njehsor	€000	330	2,188	2,302	4,820
8. Kategoria - Ndriçimi publik	€000	15	328	236	579
GJITHSEJ	€000	11,890	60,168	67,729	139,787

4.10.5 Krahësimi i tarifave të energjisë elektrike në rajonin e EJL

Edhe pas pritjes së tarifave në kuadër të SHTE3, Kosova vazhdon të mbesë ndër shtetet me tarifat më të ulëta të energjisë elektrike në rajon. Figura 4.31 në vijim dëshmon se gjatë kuartalit të parë (muajt janar – mars) të vitit 2009, tarifa më të ulëta se Kosova kanë pasur vetëm Serbia dhe Maqedonia. Kjo për arsye se gjatë këtyre muajve Kosova duhet të importojë energji elektrike me çmim më të lartë sesa prodhimi vendor për të mbuluar kërkesën. Gjatë kuartalit të dytë dhe të tretë (prill-shtator) Kosova është shteti me tarifat më të ulëta të energjisë elektrike në rajon.

Fig. 4.24. Tarifat mesatare të konsumatorëve shtëpiakë në shtetet e EJL³

Tarifat e zbatueshme nga data 1 qershor 2008 janë paraqitur në tabelën në vijim:

³ Burimi: Shoqata e Rregullatorëve Rajonalë të Energjisë

Tab.4.24. Tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Aprovuar Sezoni i Lartë 1 tetor - 31 mars	Sezoni i Ulët 1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		1,006.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		559.00	559.00
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifa e Lartë*	6.49	1.92
			€/kWh	Tarifa e Ulët*	2.70	1.58
		Energjia reaktive (Q)**	€/kVArh		0.00	0.00
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		133.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		581.00	581.00
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifa e Lartë*	6.79	2.94
			€/kWh	Tarifa e Ulët*	3.59	2.65
		Energjia reaktive (Q)**	€/kVArh		0.66	0.66
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		55.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		501.00	501.00
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifa e Lartë*	7.61	3.39
			€/kWh	Tarifa e Ulët*	4.10	3.09
		Energjia reaktive (Q)**	€/kVArh		0.66	0.66
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		31.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		291.00	291.00
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifa e Lartë*	8.45	4.69
			€/kWh	Tarifa e Ulët*	5.33	4.43
		Energjia reaktive (Q)**	€/kVArh		0.66	0.66
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		35.00	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Single tariff	10.41	6.73
			€/kWh	Tarifa e Lartë*	12.53	8.21
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifa e Ulët*	6.26	4.10
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		25.00	
		Energjia aktive (P) për konsum				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifa e Lartë*	4.64	3.33
			€/kWh	Tarifa e Ulët*	2.33	1.66
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifa e Lartë*	6.43	4.60
			€/kWh	Tarifa e Ulët*	3.22	2.31
		>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifa e Lartë*	9.33	6.68
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)		€/kWh	Tarifa e Ulët*	4.66	3.35
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		25.00	
		Energjia aktive (P) për konsum				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4.14	2.96
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e vetme	5.73	4.10
		>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	8.31	5.96
		Konsumi i vlerësuar <200kWh/month	€/konsumator/muaj		21.50	
		Konsumi i vlerësuar 200-600kWh/muaj	€/konsumator/muaj		38.92	
8	Ndriçim publik	Konsumi i vlerësuar >600kWh/muaj	€/konsumator/muaj		65.58	
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		35.00	
		Energjia aktive (P) për konsum	€/kWh	Tarifë e vetme	8.42	8.42

*Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.

**Konsumatori ngark ohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi)=0.95$

Tab.4.25. Ngarkesat e KOSTT-it

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Aprovuar
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.328
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	4.636
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	10.094
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020

4.11 Aktivitetet e ZRRE-së rreth ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese

Aktivitete kryesore të ZRRE-së gjatë vitit 2009 rreth ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese në Kosovë janë të lidhura me:

- Pjesëmarrje aktive dhe të rregullt në komitetin drejtues të “Projektit të Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti” (PATEL), si dhe
- Pjesëmarrje të përfaqësuesve të ZRRE-së në takime, punëtori të organizuara nga zyra e PATEL-it.

Gjatë vitit 2009 janë zhvilluar takime të shumta të Komitetit Drejtues të PATEL-it, veçmas duhet përmendur takimet gjatë muajit korrik, ku janë diskutuar pikat kyçe lidhur me procesin që do të sigurojë investime në realizimin e projektit për ndërtimin e TC “Kosova e Re”, si dhe propozimet për ndërtimin e TC. Propozimet janë bazuar në studimet teknike profesionale të përgatitura nga kompanitë prestigjioze, si dhe nga analizat e bëra nga këshilltarët e projektit për çështje ligjore dhe financiare. KDP në këtë periudhë ka udhëzuar këshilltarët e projektit për opsionet e finalizimit të draft-dokumentacionit të tenderit.

Gjatë vitit 2009 është shpallur edhe tërheqja e dy kompanive të kualifikuara nga gara e mëtutjeshme për Projektin e TC “Kosova e Re”. Është e njohur se si rezultat i aktiviteteve gjatë vitit 2006 kanë qenë të përzgjedhura katër kompani për zhvillimin e “PATEL-it”.

Si pikë kthese, që ka lëvizur përpara projektin për ndërtimin e termocentralit të ri “Kosova e Re”, konsiderohen përcaktimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të shpallura më 15 korrik 2009, për drejtimet e zhvillimit strategjik të sektorit energjetik, e që mund të përmbledhen si vijon:

- Përkrahet ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re” me kapacitet 2 x 500 MW, në lokacionin pranë termocentralit “Kosova B”,
- Përkrahet hapja e mihjes së thëngjillit në Sibofc,
- Rehabilitimi dhe aftësimi i TC ekzistues “Kosova B”, përmes partneritetit publiko-privat,
- Mbyllja e TC “Kosova A” të kryhet më së largu deri në fund të viti 2015,
- Vazhdimi i proceseve drejt ristrukturimit dhe privatizimit të KEK-ut,
- Përkrahet zhvillimi i kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e rinovueshme.



Fig. 4.25. Pamje e TC “Kosova B”

Takimet e KDP të organizuara gjatë muajve vijues përfundimisht kurorëzohen më 18 dhjetor 2009, kur MEM në emër të KDP ka shpallur “Kërkesën për shprehje të interesit për zhvillimin e fushës së linjitit Sibofc dhe kapaciteteve përkatëse të gjenerimit të energjisë” me këta komponentë:

- a. Ndërtimi i centralit të ri për gjenerimin e energjisë elektrike, TC “Kosova e Re” (TCKR) me kapacitet të instaluar fillestar prej 500 MW, me mundësi të zgjerimit deri në 1000 MW dhe stabilimenteve përkatëse (të limituara) të interkoneksionit;
- b. Zhvillimi i menjëhershëm i “Fushës së Linjitit në Sibofc”, për të ofruar linjit për centralet ekzistuese në Kosovë për gjenerimin e energjisë elektrike me djegie të linjitit (TC Kosova A dhe TC Kosova B) dhe njësitë e reja të TCKR kur ato të hyjnë në shërbim; dhe
- c. Participimi i sektorit privat në TC Kosova B.

Procesi i aplikimit parashihet të mbyllet më 26 shkurt 2010. (detaje të tjera për projektin PATEL mund të gjinden në ueb-faqen: <http://www.lignitepower.com> dhe mund të merren nga përfaqësuesit e zyrës).




Fig. 4.26. Vendndodhja e minierës së Sibovcit me opsionet e mundshme të zhvillimit

4.12 Hidrocentrali i Zhurit dhe perspektivat e mundshme të ndërtimit

Më 3 qershor në Prishtinë është mbajtur prezantimi i studimit të fizibilitetit të hidrocentralit të Zhurit nga konsulentët e BB në kuadër të Projektit “Asistenca Teknike Energjia nga Linjiti”. Lokacioni i centralit parashihet të jetë në jugperëndim të komunave të Prizrenit dhe Dragashit dhe ai do të ketë kapacitet 305 MW, me një prodhim mesatar vjetor të 400 GWh.

ZRRE-ja ka qenë e pranishme në grupin teknik për përcjelljen dhe koordinimin e aktiviteteve për këtë studim dhe ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet me konsulencën e këtij projekti. (Detaje të tjera për Hidrocentralin e Zhurit mund të gjinden në ueb faqen: <http://www.lignitepower.com> dhe mund të merren nga përfaqësuesit e zyrës).

5 SEKTORI I NGROHJES QENDRORE

5.1 Korniza ligjore për sektorin e ngrohjes qendrore

Përveç dy ligjeve bazë të sektorit të energjisë: Ligjit për Energjinë dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, korniza ligjore e ndërlidhur me sektorin e ngrohjes qendrore në Kosovë kompletohet me Ligjin për Ngrrohjen Qendrore. Ky ligj përcakton kushtet dhe standardet për kryerjen e veprimtarive të gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit me ngrohje, kushtet e operimit me stabilimente e pajisje të ngrohjes qendrore, organizimin e tregut dhe qasjen në rrjetin e shpërndarjes, si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që veprojnë sipas këtij ligji.

Gjithashtu, një ligj tjetër që përcakton çështje lidhur me pronësinë, qeverisjen korporative dhe mbikëqyrjen është Ligji për Ndërmarrjet Publike. Ky ligj i klasifikon ndërmarrjet e ngrohjes qendrore si ndërmarrje publike, të cilat rrjedhimisht i kalojnë në pronësi dhe mbikëqyrje komunave respektive. Më tutje, sipas këtij ligji, këto ndërmarrje organizohen si shoqëri aksionare, ku të drejtat e aksionarit i ushtron Komisioni Komunal i Aksionarëve, ndërsa mbikëqyrja e veprimtarisë së ndërmarrjeve bëhet nga Bordi i Drejtorëve, i cili zgjidhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

5.2 Pasqyrë e përgjithshme e sektorit të ngrohjes qendrore

Sistemet e ngrohjes qendrore janë të zhvilluara në katër komuna: Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan, të cilat kryesisht furnizojnë me ngrohje zonat urbane të komunave në fjalë. Duke pasur parasysh kërkesën për ngrohje, ky sektor mbetet mjaft i kufizuar dhe i vogël, duke plotësuar vetëm 5% të kësaj kërkesë.

Sistemet e ngrohjes qendrore operohen nga katër ndërmarrje respektive: Ngrohtorja e Qytetit “Termokos”, Ngrohtorja e Qytetit “Gjakova”, Njësia Punuese e Ngrrohjes Qendrore “Termomit” dhe Njësia Punuese e Ngrrohjes Qendrore “Zveçan”.

NQ “Termokos” dhe NQ “Gjakova” funksionojnë si korporata, ndërsa NjPNQ “Termomit” dhe NjPNQ “Zveçan” janë të organizuara si njësi punuese në kuadër të ndërmarrjeve komunale të Mitrovicës respektivisht Zveçanit.

Duhet theksuar se Ngrohtorja “Termomit” dhe ajo e Zveçanit, për shkak të rrethanave të njohura, nuk i përgjigjen kërkesave për rregullim dhe monitorim nga ZRRE-ja dhe, rrjedhimisht, pamundësohet sigurimi i të dhënave përkatëse të azhurnuara.

5.3 Të dhënat teknike për sistemet e ngrohjes qendrore në Kosovë

5.3.1 Gjenerimi dhe shpërndarja e ngrohjes

Implantet për gjenerimin e ngrohjes të NQ “Termokosi” përbëhen nga ngrohtorja kryesore dhe ngrohtorja ndihmëse. Ngrohtorja kryesore ka kapacitet të përgjithshëm 121.62 MW_t (termike), ndërsa ngrohtorja ndihmëse në Qendrën Klinike Universitare ka kapacitet prej 14 MW_t.

Ngrohtorja e KNQ Gjakova ka dy kaldaja me mazut, ku njëra ka kapacitet 20 MW_t ndërsa tjetra 18.6 MW, e që japin kapacitetin e tërësishëm prej 38.6 MW_t. Kaldaja me kapacitet 18.6 MW_t momentalisht është jashtë funksionit.

Karakteristikë e përbashkët e të gjithë sistemeve të ngrohjes qendrore në Kosovë është se rrjeti i tyre i shpërndarjes përbëhet nga rrjeti primar, që shtrihet deri në pikën e furnizimit në nënstacione, dhe nga rrjeti sekondar i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacione deri te shfrytëzuesit përfundimtarë.

Traseja e rrjetit primar të shpërndarjes të ngrohjes e NQ “Termokosi” ka një gjatësi prej afërsisht 30 km, me kapacitet rreth 300 MW_t, kapacitet ky i tejdimensionuar në krahasim me kapacitetin gjenerues. Pjesë integrale e rrjetit të shpërndarjes është edhe stacioni i pompimit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë, i cili gjendet në Bregun e Diellit, si dhe 260 nënstacione të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe atij sekondar.

Traseja e rrjetit primar të shpërndarjes të NQ “Gjakova” shtrihet në gjatësi prej rreth 20 km. Pjesë përbërëse e këtij rrjeti janë edhe rreth 202 nënstacione, të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe atij sekondar. Njehsorët e konsumit të ngrohjes janë instaluar në 42 nënstacione.

Tab.5.1. Të dhënat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Kompania (Qyteti)	Kapaciteti i instaluar [MW]	Kapaciteti operacional [MW]	Rrjeti i shpërndarjes		Gjenerimi i ngrohjes, sezoni 2008/09 [MWh/vit]	Furnizimi me ngrohje në Nst. të konsumatorëve, sezoni 2008/09
			Gjatësia e rrjetit [km]	Nr. i nënst.		
TERMOKOS - (Prishtinë)	2 x 58 = 116	2 x 58 = 116				
	2 x 7 = 14	2 x 7 = 14	30	260	129,517	103,668
	2 x 0,81 = 1.62	2 x 0,81 = 1,62				
	1 x 4 = 4	1 x 4 = 4				
Nën-total	135.62	135.62	30	260	129,517	103,668
NQ GJAKOVA	1 x 20 = 20	1 x 20 = 20	20	202	15,211	11,264
	1 x 18.6 = 18.6					
Nën-total	38.60	20	20	202	15,211	11,264
Total	174.22	155.62	50	462	144,728	114,932

5.3.2 Konsumi i lëndëve djegëse dhe çmimi

Ngrohoret e qyteteve janë të pajisura me kalaja të cilat kryesisht si lëndë djegëse përdorin naftën e rëndë (mazutin), që importohet me çmime referente të bursës plus “premiumi” për mbulimin e shpenzimeve të furnizuesit. Rrjedhimisht, çmimi i blerjes së mazutit ndikohet mjaft nga lëvizjet e çmimit në tregjet (bursat) ndërkombëtare; lëvizje këto që kanë qenë mjaft të mëdha dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në koston e përgjithshme të lëndës djegëse, respektivisht në koston e gjenerimit të ngrohjes.

Çmimi i naftës së rëndë për djegie (mazutit) në bursat ndërkombëtare ka qenë rreth 370 €/ton në mes të muajit tetor 2008, për të zbritur në 250 €/ton në përmbyllje të sezonit, më 15 prill 2009. Gjithashtu, lëvizje të mëdha të çmimit janë shënuar edhe me fillimin e sezonit pasues. Kështu, në mesin e tetorit 2009 çmimi i mazutit shënon rritje të madhe deri në 346 €/ton për të vazhduar me këtë trend duke arritur vlerën prej 362 €/ton në fund të vitit 2009. Në grafikun në vijim janë paraqitur lëvizjet e çmimeve të mazutit në tregjet ndërkombëtare.




Fig. 5.1. Lëvizjet e çmimit të mazutit në Bursën Amsterdam-Rotterdam-Antwerp për periudhën 15 tetor 2008 – 15 prill 2009




Fig. 5.2. Lëvizjet e çmimit të mazutit në Bursën Amsterdam-Rotterdam-Antwerp për periudhën tetor–dhjetor 2009

Burimi: web faqja :<http://tonto.eia.doe.gov> U.S. Energy information Administration Indep. Statist. and Analysis

Më poshtë janë paraqitur në formë tabelore sasia e konsumuar dhe çmimet mesatare të blerjes së lëndës djegëse (mazutit) për sezonin 2008/2009 (sipas vlerave të raportuara nga ndërmarrjet e ngrohjes qendrore).

Tab. 5.2. Konsumi i lëndëve djegëse dhe çmimi mesatar i blerjes për sezonin 2008/2009

Kompania -Sistemi i NQ-së	Mazuti	
	Konsumi (ton)	Çmimi mesatar i blerjes (€/ton)
TERMOKOS - Prishtina	12,143.34	252.59
NQ GJAKOVA	1,794.31	223.01
Totali i Sektorit të NQ	13,937.65	237.80

5.4 Furnizimi, faturimi dhe arkëtimi

5.4.1 Shërbimi i furnizimit

NQ "Termokos" furnizon me ngrohje qendrore 11,807 konsumatorë, prej të cilëve 11,034 janë konsumatorë familjarë dhe 773 konsumatorë janë komercialë e institucionalë. Sipërfaqja totale e shërbimit që ndërmarrja ka mbuluar në sezonin 2008/2009 ka qenë 1,030,932 m², që paraqet një rritje mjaft të vogël, prej vetëm 6,436 m², nga sezoni i kaluar. Në këtë sipërfaqe totale grupi i konsumatorëve familjarë merr pjesë me 634,675 m² (61.56 %), ndërsa grupi i konsumatorëve komercialë e institucionalë me gjithsej 396,257 m² (38.44%).

Në sezonin 2008/2009 NQ "Gjakova" ka pasur sipërfaqen totale të shërbimit me ngrohje prej 120,700 m², që paraqet një rënie të dukshme prej 11,000m² në krahasim me sezonin e kaluar. Arsye për këtë është kryesisht shkyçja nga sistemi e një numri të konsiderueshëm të konsumatorëve komercialë e institucionalë, si dhe atyre familjarë në ndërtesat shumëkatëshe të banimit. Pjesëmarrja e grupit të konsumatorëve familjarë në sipërfaqen totale është 61,200 m² (50.70%), ndërsa grupi i konsumatorëve komercialë e institucionalë ka 59,500 m² (49.30%).

5.4.2 Faturimi dhe arkëtimi

Efikasiteti në faturim dhe në arkëtim ka ndikim vendimtar në performansën financiare të ndërmarrjeve.

Faturimi i konsumatorëve ende është kryesisht i bazuar në sipërfaqen e paravlerësuar të ngrohjes (për metër katror), për shkak të mungesës së matjes (njehsimit) së energjisë termike të furnizuar. Edhe në këtë vit nuk është arritur niveli i planifikuar i faturimit për këto arsye: i) zbritja në fatura për shkak të ditëve pa ngrohje (për shkak të motit të mirë nuk ka pasur furnizim me ngrohje – karakteristikë e sezonit 2008/2009 ishte koha mjaft e ngrohtë gjatë gjysmës së dytë të tetorit); ii) zbritja në faturim për shkak të cilësisë së dobët të ngrohjes dhe të ndërprerjeve të furnizimit nga prishjet teknike; iii) zbritja e sipërfaqes së ngrohjes pas verifikimit në terren dhe mosfaturimi i objekteve të shkyçura në periudha të ndryshme të sezonit të ngrohjes.

Të dhënat e raportuara nga ndërmarrjet tregojnë se në sezonin e ngrohjes 2008/2009 ka pasur përmirësim në arkëtim, veçanërisht nga grupi i konsumatorëve komercialë e institucionalë. Gjatë këtij sezoni shkalla mesatare e arkëtimit për tërë sektorin e ngrohjes qendrore ka qenë rreth 61%, që paraqet një rritje për 23% nga sezoni i paraprak.

Tab. 5.3. Shkalla e arkëtimit të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore për sezonin 2008/2009

Sezoni i ngrohjes 2008/2009	Sip. ngrohëse [m ²]	Tarifa [€/m ²]	Faturimi (përf. TVSH) [€]	Arkëtimi [€]	Shkalla e arkëtimit [%]
NQ "Termokos" Prishtina					
Amvisëri	634,675	0.84	2,593,483	756,674.16	29.18
Komercial e Institut.	396,257	1.00	2,187,603	1,792,117.15	81.92
Total	1,030,932	-	4,781,086	2,548,791.31	53.31
NQ "Gjakova"					
Amvisëri	61,200	0.90	219,636	94,235.00	42.91
Komercial e Institut.	59,500	1.28	387,603	324,428.00	83.70
Total	120,700	-	607,239	418,663.00	68.95

5.5 Tarifat e ngrohjes qendrore

Kapitulli 9 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë përcakton kompetencën dhe përgjegjësinë e ZRRE-së për të hartuar metodologjinë dhe për të miratuar tarifën në sektorin e rregulluar të energjisë.

Sektori i ngrohjes qendrore në transportimin dhe shpërndarjen e ngrohjes klasifikohet si monopol natyror. Gjithashtu, në gjenerimin dhe furnizimin e ngrohjes ende nuk ekziston konkurrenca. Prandaj, tarifën e ngrohjes qendrore i nënshtrohen miratimit nga ZRRE-ja.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore për përcaktimin e tarifave të ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes 2009/2010, ZRRE ka nxjerrë:

- Udhëzimin për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrhjes
- Udhëzimin për Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrhjes

5.5.1 Metodologjia tarifore

Për formulimin/llogaritjen e tarifave dhe çmimeve të ngrohjes qendrore ZRRE ka përzgjedhur dhe zbatuar metodologjinë e Normës së Kthimit (RoR) ose të ashtuquajturën kosto plus.

Skematikisht, metodologjia RoR mund të tregohet si më poshtë:




Fig. 5.3 Skema e llogaritjes së të ardhurave të lejuara sipas metodologjisë RoR

* ΔWC: Ndryshimi në kapitalin punues

Bazuar në Metodologjinë RoR për përcaktimin e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE përcakton të Hyrat e Lejuara të cilat ndërmarrja duhet t'i realizojë përmes tarifës, d.m.th. koston e arsyeshme të lejuar, e cila duhet të rikthehet, dhe një normë të arsyeshme të profitit që llogaritet sipas Normës së lejuar të kthimit (RoR) mbi Bazën e rregulluar të aseteve (RAB).

Meqenëse tarifat përcaktohen ex-ante (bazuar në informatat e parashikuara), ZRRE-ja gjithashtu aplikon Bashkërendimin e të ardhurave të lejuara, që bazohet në ndryshimin në mes të Hyrave të lejuara të projektuara dhe atyre që faktikisht janë realizuar për sezonin paraprak. Rezultati i këtij Bashkërendimi reflektohet në të Hyrat e lejuara të sezonit vijues.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur tarifat e ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes qendrore:

Tab. 5.4. Përmbledhje e tarifave të ngrohjes qendrore për sezonin 2009/2010

A.TARIFAT E NGROHJES PËR KONSUMATORËT PA MATJE			
KOMPANITË NQ	Komponentët e tarifave	Konsumatorët shtëpiakë [€ / m ² për muaj]	Konsumatorët komercialë e institucionalë [€ / m ² për muaj]
NQ TERMOKOS SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	0.06	0.08
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	0.78	0.92
NQ GJAKOVA SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	0.13	0.17
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	0.77	1.11

B.TARIFAT E NGROHJES PËR KONSUMATORËT ME MATJE			
KOMPANITË NQ	Komponentët e tarifave	Njësia matëse	Çmimi
NQ TERMOKOS SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	€ / kW për muaj	0.59
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	€ / MWh	45.50
NQ GJAKOVA SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	€ / kW për muaj	1.33
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	€ / MWh	47.62

Në vijim paraqiten në mënyrë grafike tarifat e ngrohjes qendrore, bazuar në sipërfaqen ngrohëse (për m²) të ndërmarrjeve NQ "Termokos" dhe NQ "Gjakova".




Fig. 5.4 Krahاسimi i tarifave të ngrohjes qendrore në Kosovë

6 MBROJTJA E KONSUMATORËVE

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve është përgjegjës për sigurimin e aplikimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë. DMK është i përfshirë në këto detyra: mbrojtjen e konsumatorëve, analizimin e të dhënave të marra nga KEK-u, përqendrimin në ankesat e konsumatorëve, pjesëmarrjen në procedurat e shqyrtimit nga KEK-u në lidhje me: kyçjen dhe shkyçjen, shlyerjen e borxheve, zgjidhjen e kontesteve, ngarkesave, gjobave, etj, për të siguruar që procedurat e propozuara nuk janë diskriminuese për konsumatorët dhe se të gjithë konsumatorët trajtohen në mënyrë të barabartë.

Në vitin 2009, DMK ka proceduar një numër të madh të ankesave të konsumatorëve. Pjesa dërmuese e ankesave të konsumatorëve kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të lëshuara nga KEK-u lidhur me faturat që iu janë ngarkuar konsumatorëve për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Problem i veçantë që duhet theksuar për këtë vit është prapë numri i madh i proceseve që KEK ka bërë për shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike, e posaçërisht proceset në lidhje me abuzimet e njehsorëve nga konsumatorët.

Shumica e konsumatorëve që janë ngarkuar nga KEK-u me faturë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike dhe të cilët, pas parashtrimit të ankesave të tyre në KEK, kanë marrë përgjigje negative, kanë parashtruar ankesë në DMK.

6.1 Ankesat dhe aktivitetet në zgjidhjen e kontesteve

DMK në vitin 2009 ka regjistruar 318 ankesa të konsumatorëve, prej tyre janë zgjidhur 142 ankesa, ndërsa kanë mbetur të pa zgjidhura edhe 176 ankesa. Poashtu DMK ka zgjidhur edhe 19 ankesa të nga viti 2008.

Tabela 6.1 Ankesat e regjistruara, zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2009 në DMK

Ankesat		
Regjistruara	Zgjidhura	Të pa zgjidhura
318	142	176

Gjatë vitit 2009 janë kthyer në rishqyrtim 25 ankesa të konsumatorëve komercial në Departamentin për Konsumatorë në KEK, për shkak të moszbatimit të saktë nga KEK të rregullave dhe të procedurave në fuqi.

Shumica e ankesave të konsumatorëve që janë regjistruar edhe gjatë vitit 2009, kanë qenë kundër përgjigjeve të lëshuara nga KEK-u, dhe natyra e tyre ka qenë kundërshtim për faturat që iu janë ngarkuar konsumatorëve për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Ankesat e regjistruara në DMK janë të këtyre natyrave:

- shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike
- regjistrim i pasaktë i energjisë elektrike
- gjobat për shkyçje
- lexim/faturim i pasaktë
- bartje borxhi

- parapagimi i RTK, etj.

Gjatë vitit 2009, DMK ka zhvilluar 894 biseda direkte dhe 111 biseda telefonike me palët që i janë drejtuar ZRRE-së për çështje të ndryshme e që drejtpërdrejt janë të ndërlidhura me ankesa të konsumatorëve. Stafi i DMK në bisedat direkte me palët vazhdimisht ka udhëzuar dhe njoftuar palët me rregullat dhe procedurat, me qëllim që palët të jenë sa më mirë të informuara me to.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të konsumatorëve të regjistruara gjatë vitit 2009, 76 % prej tyre kanë qenë ankesa të konsumatorëve për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, ndërsa 24 % kanë qenë të natyrave të ndryshme.

Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike është i lidhur drejtpërdrejt me humbjet komerciale të energjisë elektrike. Duhet të theksohet se me rastin e analizimit të këtyre ankesave janë vërejtur shumë mangësi në proceset e përgatitura nga ana e punëtorëve të KEK-ut

Në grafikun 6.2 janë paraqitur numri i ankesave të regjistruara sipas natyrës së tyre, ku shihet qartë se numri më i madh i ankesave të konsumatorëve ka qenë shfrytëzimi e paautorizuar të energjisë.




Fig 6.2. Paraqitja grafike e ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre

Numri i ankesave sipas grupeve të konsumatorëve:

- konsumatorët familjarë, 257 ankesa ose 81%, dhe
- konsumatorët komercialë, 61 ankesa ose 19 %;
- konsumatorëve industrialë, nuk është regjistruar asnjë ankesë.

Në tab. 6.2 është pasqyruar rrjedha e ankesave sipas viteve, ku shihet qartë se viteve të fundit është rritur numri i ankesave të regjistruara, gjë që paraqet ngarkesë të madhe të departamentit.

Tabela 6.2 Krahësimi i ankesave të konsumatorëve gjatë viteve

Viti	2006	2007	2008	2009
Gjithsejt	33	116	572	318

7 PERSPEKTIVA E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË KOSOVË

Është i njohur fakti se në Kosovë momentalisht nuk është prezent gasi natyror; gjithashtu nuk ekziston asnjë infrastrukturë e gazit, përveç rrjetit të vjetër dhe të shkatërruar të gazit artificial nga linjiti, i cili përshkon trasenë me gjatësi të përgjithshme prej 254 km.

Në vijim të kompletimit të kornizës ligjore dhe përmbushjes së obligimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore (TKE EKL), në nëntor të vitit 2009 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Gazin Natyror. Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror në Kosovë, qasjen ndaj tregut, kushtet dhe kriteret për kryerjen e veprimtarive të bartjes, deponimit, shpërndarjes dhe furnizimit të gazit natyror.

Perspektiva e zhvillimit të infrastrukturës dhe furnizimi me gaz natyror në Kosovë, nga institucionet përkatëse të vendit dhe ato ndërkombëtare, është konsideruar si mundësi reale në të ardhmen. Kjo kryesisht për shkak të pozitës gjeostrategjike të vendit tonë në qendër të rajonit të Evropës Juglindore, përmes të cilit parashihen të kalojnë linjat e gazsjellësit që lidhin burimet e gazit natyror në rajonin e Kaspikut dhe në Rusi me vendet e zhvilluara të Evropës Perëndimore.



Fig. 7.1. Koncepti i "Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë"

Burimi: Studimi i Gazifikimit të Evropës Juglindore –KfW-WB (Gasification Study of SEE – KfW-WB)

Një ndër objektivat strategjike të "Strategjisë së Sektorit të Energjisë së Kosovës" është lidhja e Kosovës me gazsjellësit rajonalë në të ardhmen e afërt. Gjithashtu "Studimi i Gazifikimit të Evropës Juglindore" ka propozuar konceptin e "Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë", e cila lidh shtatë vende të Evropës Juglindore, dhe në këtë kuadër ka shqyrtuar mundësinë ekonomike të hyrjes së gazit natyror në Kosovë dhe ka konkluduar se furnizimi i konsumit industrial dhe komercial do të ishte i realizueshëm (fizibël).

Një zhvillim me rëndësi në vitin 2009 ishte përfshirja e Kosovës në raportin "Skenarët e Kërkesës ndaj Kapacitetit" në kuadër të projektit për hartimin e "Planit Zhvillimor 10 vjeçar të Rrjetit Evropian të Gazit" nga GTE+ (Gas Transmission Europe – Transmisioni Gazit në Evropë). Për këtë qëllim, dhe

sipas kërkesës së GTE+ për plotësimin e pyetësorit, MEM në bashkëpunim me ZRRE-në dhe palët tjera të involvuara ka kryer parashikimet për kërkesën e gazit natyror në Kosovë në periudhën 2015 - 2025, dhe planin preliminar për zhvillimin e rrjetit të transmisionit si dhe skemën ("lay-out") e këtij rrjeti që janë për diskutim dhe analizim të mëtutjeshëm.

Tab. 7.1. Parashikimet për kërkesën e gazit në Kosovë sipas sektorëve

Sektorët	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Gazi natyral si lëndë e dytë e TC me thëngjill	0.00	0.00	246.43	254.35	262.28	270.20	278.13	286.06	293.98	301.91	309.83
Gazi natyral për TC me cikël të hapur&kombinuar	0.00	0.00	0.00	0.00	133.97	138.02	142.07	146.12	150.17	154.22	158.27
Total_NQ	0.00	0.00	78.17	80.51	89.66	99.03	101.89	104.85	107.88	111.01	114.23
Total_industria	10.59	18.12	47.10	84.82	144.85	211.28	261.87	300.73	322.65	335.25	347.44
Total_Ndërtesat Komerciale & Publike	4.25	7.19	23.93	36.58	76.12	107.81	130.13	146.07	152.64	155.81	159.04
Total_Ndërtesat urbane të banimit	5.33	9.33	26.37	38.47	79.54	113.84	140.81	162.17	173.08	180.07	187.19
Totali	20.17	34.64	422.00	494.73	786.42	940.18	1,054.90	1,146.00	1,200.40	1,238.27	1,276.00

Burimi: Raporti GTE+ Skenarët e Kërkesës ndaj Kapacitetit (GTE+ Report Demand Scenarios vs. Capacity)




Fig.7.2. Plani preliminar i rrjetit të transmisionit të gazit natyror të Kosovës




Fig. 7.3. Skema ("Lay-out"-i) e planit preliminar të rrjetit të transmissiionit të gazit natyror të Kosovës

Burimi: Raporti GTE+ Skenarët e Kërkesës ndaj Kapacitetit (GTE+ Report Demand Scenarios vs. Capacity)

Vijat me të kuqe tregojnë linjat e rrjetit të transmissiionit të segmentit kosovar të Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë; Vijat me të kaltër tregojnë rrjetin e brendshëm të transmissiionit

Në vijim të plotësimit të përgjegjësiave ligjore për zhvillimin e kornizës rregullative dhe obligimeve karshi TKE EJT, gjatë vitit 2009 ZRRE ka përcjellë zhvillimet rajonale lidhur me gazin natyror dhe ka marrë pjesë aktivisht në punën e Grupit punues të gazit në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë dhe të Forumit të Gazit. Në këtë aspekt, ndër tjera, ZRRE ka kontribuar me dhënien e informatave, komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve për përgatitjen dhe finalizimin e dokumenteve ndër të cilat veçojmë:

- Draft-Raportin: "Korniza Rregullative për Zhvillimin e Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë" – ky dokument elaboron instrumentet e mundshme rregullative për të mundësuar realizimin e konceptit të Unazës së Gazit;
- Raportin final: "Studimi për përmirësimin e ndërlidhjeve, ndër-operativitetit, transparencës dhe harmonizimit të rregullave operacionale për transportimin e gazit natyror në Komunitetin të Energjisë.

Të gjitha dokumentet, raportet dhe studimet relevante për gazin natyror gjenden në faqen zyrtare të Traktatit të Komunitetit të Energjisë: www.energy-community.org

8 AKTIVITETETI NDËRKOMBËTAR I ZRRE-SË

8.1 ZRRE-ja dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore

Komuniteti i Energjisë së Evropës Juglindore praktikisht është zgjerim i tregut të UE në këtë rajon. Komuniteti është themeluar me Traktatin, të ratifikuar nga të gjitha palët në rajon: Shqipëria, Bulgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova (si UNMIK), Maqedonia (FYROM), Mali i Zi, Serbia dhe është në fuqi që nga 1 korriku 2006.

Synimet kryesore të Komunitetit të Energjisë janë: ndërtimi i kornizës rregullative dhe asaj të tregut, tërheqja e investimeve dhe sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm me energji, krijimi i tregut të integruar që lejon tregtim ndërkufitar, integrimi në tregun e UE; të rritet sigurimi i furnizimit dhe futja e konkurrencës, si dhe përmirësimi i gjendjes së mjedisit.

Që nga marsi i 2009, 14 shtete të UE kanë statusin e “pjesëmarrësit” në komunitete: Austria, Bulgaria, Republika Çeke, Qiproja, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia dhe Britania e Madhe, ndërsa statusin e “vëzhguesit” e kanë: Gruzia, Moldavia, Norvegjia, Turqia dhe Ukraina.




Fig.8.1. Përbërja dhe grupet punuese me nëngrupe të Bordit Rregullativ të Traktatit të Energjisë për Evropën Juglindore

Institucionet kryesore të themeluara për mbikëqyrjen e proceseve në TKE EJT janë: Këshilli Ministror, Grupi i përhershëm i nivelit të lartë, Bordi Rregullativ (BRR) i Komunitetit, Fora dhe Sekretariati. Bordi Rregullativ për Energji i Komunitetit është institucion i vendosur sipas Nenit 58 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe, përveç të tjerave, ka rolin e trupit koordinues midis rregullatorëve nacionalë, duke zhvilluar zgjidhje më të mira rregullative dhe të harmonizuara në implementimin e detyrave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Sekretariati i Traktatit të Komunitetit të Energjisë i udhëheq dhe i koordinon aktivitetet e Bordit Rregullativ (BRR) dhe është i vendosur në Vjenë. Në Fig. 7.1 është treguar skema organizative e BRRK me grupet dhe nëngrupet punuese.

Objektivat dhe prioritetet kryesore afatgjate të BRR janë: Zhvillimi i tregut konkurrues, integrimi i tregjeve nacionale në tregun rajonal në sektor të gazit dhe të energjisë elektrike, identifikimi dhe eliminimi i pengesave në tregtimin ndërkufitar si dhe në konkurrencë, mbrojtja e konsumatorëve dhe çështjet sociale, sigurimi i furnizimit nga këndvështrimi rregullativ, siguria e rrjetit dhe cilësia e shërbimeve, zhvillimi i kornizës rregullative për burime të rinovueshme dhe përdorimi eficient i energjisë. Bordi Rregullativ i Komunitetit të energjisë takohet katër herë gjatë vitit dhe vendi i takimeve është Athina. Ai drejtohet nga kryetari i BRR, ndërsa Komisioni Evropian me përfaqësuesin e vet vepron si nënkryetar i BRR. BRR ka tri grupe punuese: gaz, energji elektrike dhe konsumatorë. Si grup i katërt është themeluar Grupi Implementues për Zyrën e Ankandit (Aukcionit) të Koordinuar të EJL (GI ZAK të EJL). Pjesëmarrës në grupe, përveç rregullatorëve, janë operatorët e sistemeve, tregtarët dhe përdoruesit e sistemit. Brenda grupeve punuese janë të formuara edhe nëngrupe ("Task force") që trajtojnë detyra të veçanta.

Rajoni i tetë është përkufizuar nga Këshilli Ministror i TKE në takimin e Brukselit të datës 27 qershor 2009, në formë të amendamentimit të Aneksit të Rregullores (EC) nr. 1228/2004 për kushtet e qasjes në rrjet dhe të shkëmbimeve ndërkufitare të energjisë. Shtetet e Rajonit të 8-të janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Kosova (si UNMIK), Greqia, Sllovenia, si dhe Italia, në pajtim me lidhjet e interkoneksionit me palët aderuese të TE. Në këtë takim është vendosur që shtetet e mësipërme duhet të zbatojnë metodën e menaxhimit të koordinuar të kongjestionit, si dhe procedurat e alokimit të kapaciteteve në treg së paku në bazë vjetore, mujore dhe ditore, jo më larg se 31 dhjetori 2009

ZRRE-ja ka të nominuar anëtarët e vet në BRR dhe në çdo grup punues që vepron në emër të Kosovës për çështje rregullative. Takimet e grupeve punuese mbahen në Vjenë dhe në Athinë.

Në pajtim me synimet e saj gjatë vitit 2009, BRR ka kontribuar në harmonizimin e legjisllacionit rregullativ në sektor kyç, si gazi, energjia elektrike dhe çështjet e lidhura me konsumatorë. Një aktivitet i veçantë i është kushtuar themelimit të Zyrës së Ankandit për Evropën Juglindore.

8.1.1 Aktivitetet e BRRKE gjatë vitit 2009

- Menaxhimi i kongjestionit dhe alokimi i kapaciteteve transmetuese (TF-1) paraqet një qasje të harmonizuar dhe transparente për alokim të kapaciteteve ndërkufitare, që është parakusht i funksionimit të tregut rajonal të energjisë elektrike. Kështu, pas përfundimit të fazës së ashtuquajtur "Ngasje në të thatë" – "Dry-Run" dhe bazuar në komentet dhe diskutimet ndërmjet palëve të interesit, do të themelohet Zyra e Përgjithshme e Ankandit nga OST të EJL. Rregullatorët kanë luajtur rol të rëndësishëm në këtë aktivitet dhe gjithashtu ata janë pjesë e vendimmarrjes së rregullave të ankandit e që duhet të përgatiten nga operatorët e transmiseve.
- Problematika e Mekanizmit Rajonal Balancues ka filluar të shtjellohet më 2007 dhe pritet që në të ardhmen të jepen hapat e mëtutjeshëm të zhvillimit të Sistemit Balancues Rajonal. Zhvillimi i platformës - softuerit rajonal për balancim " BETSEE" ka vazhduar në bazë të rezultateve të vitit 2008. Azhurnimi i softuerit ka qenë i mbështetur financiarisht nga BRR. Në fund të vitit 2009 është kryer një "Ngasje e thatë" në prezencë të një numri të madh të pjesëmarrësve nga shtetet e rajonit.
- Hapja e tregut rajonal me shumicë të energjisë elektrike dhe pajtueshmëria e rregullave të tregut është ndër shtyllat kryesore të zhvillimit të ardhshëm rajonal të tregut në EJL. Si kusht i zhvillimit të tillë është harmonizimi i nevojshëm i qasjes rregullative. Banka Botërore e ka financuar studimin për hapjen e tregut rajonal me shumicë, dhe viti 2009 ka qenë i përcjellë me shumë komente nga Grupi i punës për energji elektrike, përfshirë edhe komentet e ZRRE-së. Studimi pritet të kryhet gjatë vitit 2010.

- Harmonizimi i licencave (nëngrupi TF4) ka qenë një aktivitet tjetër i BRR. Posaçërisht aktivitetet lidhur me harmonizimin e licencave për tregtim mbeten prioritet me qëllim të njohjes së ndërsjellë.
- Duke pasur parasysh madhësinë e tregjeve nacionale, bashkëpunimi ndërmjet rregullatorëve sa i përket investimeve ndërkufitare dhe planifikimit (TF5), është gjithashtu temë e rëndësishme e rajonit. Gjatë vitit 2009 ka filluar përgatitja e një dokumenti konsultativ në këtë temë dhe pritet të përfundohet gjatë vitit 2010.
- Grupi punues i gazit, gjatë vitit 2009, është përqendruar në vendosjen dhe harmonizimin e kornizës rregullative për të lehtësuar zhvillimin e “Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë”, që synon promovimin e infrastrukturës së re dhe asaj shtesë të gazit në Komunitetin e Energjisë. Kjo me qëllim final të ndërlidhjes së tregjeve nacionale të gazit dhe krijimit të tregut rajonal të gazit të Evropës Juglindore. Rrjedhimisht, ndër detyrat e Grupit Punues të Gazit është implementimi i “acquis communautaire” të gazit natyror, tregtia dhe bashkëpunimi ndërkufitar, interkoneksioni dhe interoperativiteti i linjave të transmissioinit dhe tranzitimit të gazit natyror, dhe harmonizimi i tarifave të transmissioinit. ZRRE aktivisht është kyçur në punën e GPG, me pjesëmarrje në takimet e këtij grupi dhe Forumit të Gazit, si dhe me dhënien e informatave, të dhënave dhe komenteve për hartimin e dokumenteve relevante.
- Grupi punës për konsumatorë, gjatë vitit 2009, ka mbajtur 4 takime të rregullta. Aktivitetet kryesore kanë qenë të lidhura me mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, kualitetin e furnizimit me energji, si dhe studimin lidhur me tarifat e shpërndarjes së gazit dhe kualitetit të furnizimit. BRR ka aprovuar dokumentin mbi mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe raportin lidhur me kualitetin e shërbimeve të energjisë – standardet dhe nxitjet në kualitetin e furnizimit. Dokumentet janë të publikuara në faqen elektronike të BRR.

Gjithashtu, BRR ka vazhduar rolin këshillëdhënës për Këshillin Ministror të TKEJL në çështje: të monitorimit dhe qasjes së punës të sistemit elektroenergjetik dhe tregut rajonal me sugjerime për funksionim të rregullt të tregut rajonal; punës drejt një tregu të përbashkët të energjisë elektrike dhe gazit, të hapjes së mëtutjeshme të tregut, njohjes reciproke e licencave në rajon, të marrjes së qëndrimit në lidhje me balancimin rajonal, dhe të krijimit të Zyrës së Auksionit për rajonin e Evropës Juglindore.



Fig. 8.2. Shtetet anëtare të TKEJL

Gjatë vitit 2009, në shumë dokumente të përgatitura nga grupet punese si dhe nga konsulenca e TKE, Operatori i Transmisionit të Kosovës (KOSTT) ka vazhduar të trajtohet në mënyrë jo të barabartë në raport me Operatorin e Transmisionit të Serbisë. Qysh në vitin 2008 kontesti është ngritur nga KOSTT në Sekretariatit e TKE të EJL, por ende nuk ka ndonjë vendim për këtë.

Gjatë vitit 2009 janë mbajtur dy takime të Forumit të Athinës të TKE për EJL. Në takimin e parë, të mbajtur më 13 maj 2009, si çështje kyçe Forumi ka mbështetur aktivitetet që janë kryer në themelimin e zyrës së ankandit për alokim të kapaciteteve ndërkufitare bartëse, dhe njëkohësisht ka shprehur brengosjen për pjesëmarrjen e vetëm pesë OST nacionale në ZA. Janë ftuar qeveritë dhe rregullatorët të harmonizojnë legjislacionin nacional me sugjerimet e studimit të TKE për themelimin e ZA. Janë prekur edhe çështjet e lidhura me metodologjinë e tarifave, me tarifa si dhe me ndikimet e tyre në konsumatorë, dhe është sugjeruar që tarifat të shprehin kostot reale dhe t'iu iket subvencioneve. Problematika e ndërtimit të tregut, transparencës dhe monitorimit të tregut ka qenë e diskutuar në mbështetje të zhvillimit të mëtutjeshëm në pajtim të plotë me "Acquis". Në takimin e dytë të Forumit, të mbajtur më 25 nëntor 2009, është mirëpritur pakoja e tretë legjislative e Komisionit Evropian, si dhe krijimi i ENTSO-E, organizatës së operatorëve nacionalë të Evropës, me theks në nevojën e koordinimit ndërmjet OST në EJL në kuadër të TKE. Edhe në këtë takim u mbështetën aktivitetet që janë duke u zhvilluar rreth zyrës rajonale të ankandit, u mirëpritën sugjerimet e bëra në versionin e azhurnuar të studimit "Hapja e Tregut me Shumicë në Rajonin e EJL", të kryer nga konsulenca e traktatit, e financuar nga Banka Botërore si dhe çështjet e lidhura me investime në infrastrukturë të transmisionit dhe çështjet e lidhura me sigurinë e furnizimit në pajtim me Direktivën 2005/89/EC.

Zyra e Rregullatorit për Energji ka vazhduar edhe në 2009 bashkëpunimin me Sekretariatit e TKE, duke plotësuar shumë pyetësorë dhe ka kontribuar në azhurnimin e Raportit Nacional për Kosovën, që publikohet nga vet sekretariati.

8.2 Asociacioni i Rregullatorëve Rajonalë për Energji

Asociacioni i Rregullatorëve Rajonalë për Energji (ARRRE- ang.ERRA), është organizatë e pavarur e themeluar më 2001, me pjesëmarrje të agjencive të pavarura rregullative në radhë të parë nga shtetet e Evropës Qendrore, rajonit Euroaziatik, Azisë, Lindjes së Mesme dhe SHBA. Synimet kryesore të ARRRE janë të nxisë shkëmbimin e informative dhe zgjerimin e përvojave rregulative në rajon dhe në botë. Sekretariati i ARRRE është i vendosur në Budapest të Hungarisë. Financimi i aktiviteteve kryesisht mbulohet nga shtetet anëtare, ndërsa në fillim të themelimit, NARUC dhe USAID kanë qenë mbështetësit kryesorë financues. ZRRE-ja është anëtare e bashkangjitur e asociacionit.

ARRRE i ka këto grupe/komitete punuese: Komiteti për licencim dhe konkurrencë, Komiteti për tarifa, Komiteti ligjor, Komiteti i kryetarëve dhe Komiteti për Gaz. ZRRE përfaqësohet në të gjitha këto grupe punuese të këtij asociacioni.

- Grupi për licenca dhe konkurrence gjatë vitit 2009 ka pasur tri takime, në të cilat janë shtjelluar tema nga: licencimi/konkurrenca, balancimi i kapaciteteve, çmimet e tregut, tregu rajonal me shumicë, monitorimi, etj.
- Komiteti për tarifa, gjatë vitit 2009, ka zhvilluar katër takime, në të cilat janë diskutuar kryesisht çështjet e tarifave, rregullimi cilësor nëpërmjet çmimeve, tregu rajonal etj.
- Komiteti ligjor ka pasur dy takime gjatë vitit 2009, me qëllim takimin e stafit të rregullatorëve që merren me çështje rregullative, licencim dhe çështje të zgjidhjeve të kontesteve të konsumatorëve.
- Komiteti i kryetarëve ka pasur dy takime, në të cilat janë shqyrtuar tema nga çështjet e tregut, kriza globale financiare, monitorimi i tregut, çështjet e mungesës së gazit në Evropën

Qendrore dhe në atë Juglindore, burimet e rinovueshme, çështjet e lidhura me konsumatorët socialë etj.

- Komiteti për gaz është formuar më 2008, me qëllim të analizës së parakushteve rregullative për krijimin e tregut rajonal të gazit dhe zhvillimin e legjislacionit rregullativ të harmonizuar.
- ZRRE ka bashkëpunuar aktivisht me ARRRE me pjesëmarrje aktive në takime, komentim të dokumenteve dhe duke u përgjigjur në pyetësorë të ndryshëm nga sektori i energjisë.

8.3 Partneriteti ndërmjet Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Komisionit Komercial të shtetit Illinois, SHBA

Partneriteti i nënshkruar gjatë vitit 2008 ndërmjet Agjencisë Rregullative të Illinois-it (Illinois Commerce Commission-ICC) të SHBA dhe ZRRE ka vazhduar edhe në vitin 2009. Partneriteti mbështetet financiarisht nga USAID-i, ndërsa aktivitetet udhëhiqen nga NARUC-u.

Gjatë zhvillimit të këtij bashkëpunimi janë mbajtur punëtori teknike-seminare, trajnime dhe zhvillim institucional në mes të dy partnerëve. Temat të cilat janë trajtuar kanë qenë nga fusha rregullative me temat: monitorimi i tregut dhe i licencave, shqyrtimi i tarifave, procedurat vendimmarrëse, mbrojtja e konsumatorëve, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, si dhe çështjet e tjera sfiduese që janë përpara këtyre dy institucioneve.

Takimi i parë është mbajtur në vitin 2008 në Prishtinë, ndërsa gjatë vitit 2009 janë zhvilluar edhe dy aktivitete njëjavore të partneritetit, njëri është mbajtur në Illinois dhe tjetri në Prishtinë. Në aktivitetin e dytë të këtij partneriteti që është zhvilluar në Chicago dhe Washington, nga data 8 deri më 12 qershor të vitit 2009 kanë marrë pjesë pesë anëtar të stafit të ZRRE-së, dy prej të cilëve anëtarë të Bordit, dy drejtues të departamenteve dhe një ekspert. Gjithashtu, gjatë këtij udhëtimi përfaqësuesit e ZRRE-së janë takuar edhe me përfaqësuesit e Rregullatorit Federal të SHBA-së, USAID-it dhe NARUC-ut.

Nga data 2 deri 6 nëntor ZRRE dhe ICC janë takuar për herë të tretë në Prishtinë dhe kanë zhvilluar diskutimet e tyre teknike dhe politikat rregullative. Partnerët kanë zhvilluar diskutime të thella në grupe paralele teknike që janë fokusuar në zhvillimet e tarifave dhe të çmimeve, mbrojtjen dhe shërbimet më të mira për konsumatorët, licencimin dhe monitorimin e aktiviteteve të energjisë, si dhe burimet e rinovueshme. Ky partneritet është paraparë të zgjasë deri në shtator të vitit 2010.

Përveç punëtorive të mbajtura në ZRRE, për të kuptuar më mirë strukturimin e sektorit të energjisë në Kosovë, janë zhvilluar edhe takime me Departamentin e KEK-ut për çështje Rregullative dhe Zyrën e KEK-ut për Përkujdesje të Konsumatorëve, si dhe është vizituar qendra Dispeçerike e KEK-Divizioni i Shpërndarjes.

Adresat e ZRRE-së

Zyra e Rregullatorit për Energji

Rruga: Hamdi Mramori nr. 1

Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 247 615

Fax: +381 (0) 38 247 620

Email: info@ero-ks.org

Web: www.ero-ks.org

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Tel: +381 (0) 38 247 615 lok. 101

Sekretaria:

Tel: + 381 (0) 38 247 615 lok. 104

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve:

Tel. + 381 (0) 247 615 lok. 116 dhe 125

Email: ankesa.dmk@ero-ks.org

